

1 E hënë, 8 korrik 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.03

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm
13 në sallën e gjyqit sot.

14 Përpara se të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të
15 Prokurorisë me numër 4752, ju rikujtoj të gjithëve që
16 programin këtë javë e kemi njësoj si javën e kaluar. Çka do të
17 thotë, Dëshmitari 04752 do të japë dëshmi gjithë ditën e të
18 hënës, do japë dëshmi deri në pushimin e drekës të martën,
19 dëshmi ditën e plotë të mërkurën dhe vetëm seancën e parë,
20 pra, deri në 11.00 ditën e enjte.

21 Më pas, seancën e radhës do të jetë dëshmitari 04051
22 ditën e enjte.

23 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit të
24 Prokurorisë 4752.

25 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Do të doja të trajtoja një

1 aspekt me ju, i nderuar Gjykatës, përpara se të vijë
2 dëshmitari në sallë, ju lutem.

3 Z. Krasniqi ka pas një kollare sot në mëngjes, dhe ia
4 kanë hequr. A mund të na thotë dikush pse i është hequr
5 kollarja z. Krasniqi sot paradite?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të jem i
7 singertë, as që e kam haberin, por do interesohem dhe do ju
8 them.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Ju lutem, sa më shpejt na e
10 jepni këtë informacion, do e vlerësonim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ma merr
12 mendja -- nuk po them asgjë, do ta -- do interesohem.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Sa për procesverbal, z.
14 Krasniqi këtë kollare e ka veshur dhe herë të tjera në sallën
15 e gjyqit. A mund ta dimë arsyen se pse i është hequr kollarja?

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thashë që
17 do interesohem dhe do t'ju them.

18 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
21 Dëshmitar. Z. Zyrapi është kënaqësi t'ju shohim sërish.

22 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dua t'ju
24 rikujtoj edhe një herë të përgjigjeni qartë, me fjali të
25 shkurtra, nëse nuk e kuptoni pyetjen kërkoni që të përsëritet

1 apo që ta sqarojmë pyetjen. Gjithashtu, mos harroni të na
2 thoni ku e bazoni ju faktet, rrethanat për të cilat do të
3 jepni dëshmi.

4 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
5 se të përgjigjeni, si dhe flisni ngadalë për hir të
6 përkthyesve. Në çdo moment që keni nevojë për pushim, ju lutem
7 na informoni në mënyrë që ta bëjmë të mundur.

8 Ju rikujtoj se jeni ende nën betim për të thënë të
9 vërtetën, sikurse vetë e cituat përmes deklaratës solemne.

10 Siç ju thashë dhe javën e kaluar, nuk jeni i detyruar t'u
11 përgjigjeni pyetjeve që mund të jenë vetinkriminuese me
12 përjashtim të rasteve kur ua kërkon Trupi Gjykses. Nëse del
13 një pyetje e tillë, mund ta trajtoni këtë përmes Avokatit
14 tuaj, dhe do vendosim ne pastaj nëse do të përgjigjeni apo jo,
15 dhe në ç'rrethana do t'ju detyrojmë që të përgjigjeni.

16 Tani do të vazhdojmë me kundërpjetet. Jemi ende me
17 Mbrojtjen e Thaçit. Ju lutemi, dëgjojin me vëmendje.

18 Vazhdoni, z. Misetic.

19 DËSHMITARI: BISLIM ZYRAPI (Vijon)

20 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Mirëmëngjes, z. Zyrapi.

23 PË. Mirëmëngjesi.

24 PY. Do doja që shkurtimisht të flisnim për atë takim që
25 është mbajtur me komandantët e zonës më 6 shkurt të 1999. A ju

1 kujtohet ai takim?

2 PË. Po, takimi më kujtohet.

3 PY. Në rregull.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem tani Sekretarit të seancës
5 që të vendosë në ekran provën materiale që mban numrin P00182,
6 në faqen 34, si në anglisht edhe në shqip.

7 Faqen 34, ju lutem, si në anglisht si në shqip.

8 PY. Dëshmitar, besoj se këto pjesë ua tregoi edhe Prokuroria
9 javën e shkuar, megjithëse unë kam disa pyetje në lidhje me
10 këto. Është një pjesë e takimit ku më duket se flet Syla,
11 Sylejman Selimi, pra. Syla është Sylejman Selimi, saktë?

12 PË. Saktë, saktë.

13 PY. Pika e dytë, ai thotë:

14 "Emërimet që janë bërë në Shtabin e Përgjithshëm janë
15 shqetësuese. (Sokol Bashota dhe Jakup Krasniqi). Besoj se
16 Sokol Bashota nuk është i përshtatshëm për punën e
17 zëvendëskomandantit. Shtabi i Përgjithshëm e ka shpërfillur
18 kërkesat që u kemi bërë ne në lidhje me këtë."

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë tek faqja
20 tjetër tek anglishtja.

21 PY. Pastaj vazhdon:

22 "Jakup Krasniqi po ashtu, me gjithë respektin që i takon,
23 nuk është personi i duhur për postin e zëvendëskomandantit."

24 Ju konfirmuat ditën e enjte që ky kur është mbajtur ky
25 takim, komandantët e zonës e kanë ditur që komandanti i

1 përgjithshëm ka qenë Azem Sylja. Edhe nga ky tekst, kuptohet që
2 pjesëmarrësit e takimit e kanë ditur kush ka qenë komandanti i
3 përgjithshëm, kështu?

4 PË. Ato çka di, po.

5 PY. A pajtoheni me mua që ata, nëse ata e dinin që UÇK-ja ka
6 pasur zëvendëskomandant, atëherë i takon që të ketë pasur dhe
7 një komandant të përgjithshëm të UÇK-së në kohën kur është
8 mbajtur ky takim, kështu?

9 PË. Po, kështu është.

10 PY. T'i kthehemi marrëveshjes së Rambujesë. Javën e kaluar
11 folëm, e thamë që komandantët e zonave kanë qenë kundër
12 nënshkrimit të Rambujesë, pjesërisht, sepse në marrëveshje
13 kërkohej çarmatimi i UÇK-së, e për rrjedhojë ata mund të
14 humbisnin autoritetin e tyre. A ju kujtohet ky diskutim që
15 bëme javën e shkuar?

16 PË. Po.

17 PY. Tani, marrëveshja e Rambujesë --

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Më falni, më mirë shohim
19 fillimisht në ekran provën materiale 1D29, ju lutem -- 69.

20 PY. Ndërkohë që presim të dali materiali në ekran, a ju
21 kujtohet që një nga mënyrat se si i bindi z. Thaçi komandantët
22 e zonave të nënshkruanin, më saktë, të jepnin pëlqimin e
23 Rambujesë, u tha se do të merrnin pjesë në Qeverisë së
24 Përkohshme si dhe në gardën kombëtare. Ju kujtohet?

25 PË. Po.

1 PY. Dokumenti që kemi në ekran mban datën 23 shkurt 1999, që
2 është tre ditë pas takimit që diskutoi Prokuroria me ju, pra,
3 ai takimi i Shtabit të Përgjithshëm ku z. Thaçi u zgjodh të
4 ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme. Këtë dokument që
5 kemi në ekran, a e keni parë ndonjëherë më përpara?

6 PË. Jo.

7 PY. A e keni ditur ju më 26 shkurt që ishte nënshkruar një
8 marrëveshje në Rambuje, nga z. Thaçi në emër të UÇK-së, nga
9 Dr. Ibrahim Rugova në emër të LDK-së, dhe z. Rexhep Qosja në
10 emër të LBD-së për të formuar Qeverinë e Përkohshme të
11 Kosovës, o më saktë për të themeluar qeverinë në vijim të
12 marrëveshjes së Rambujesë?

13 PË. Nuk e di, po në atë takim kur janë kthyer nga Rambujeja
14 delegacioni, atëherë na kanë informuar që është bërë
15 nënshkrimi i tillë.

16 PY. Dhe jeni informuar ju në atë kohë se edhe LDK-ja mendohej
17 se do të ishte pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

18 PË. Po.

19 PY. A e keni ditur ju se përfundimisht LDK-ja vendosi të mos
20 ishte pjesë e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës pas fillimit
21 të bombardimeve të NATO-s?

22 PË. Po.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani, të shohim në ekran
24 materialin DHT04018 deri në DHT04028 në faqen 5 te anglishtja
25 dhe DHT04022 deri DHT04022 në shqip.

1 PY. Kjo është një përmbledhje e lajmeve të 12 majit 1999.
2 Shohim paragrafin e dytë tek anglishtja, ndërkohë që presim të
3 shfaqet dhe shqipja në ekran. Thotë:

4 "Kosovopress dje, shtypi i Kosovës dje, nxori një
5 intervistë me shefin e UÇK-së Hashim Thaçin në të cilën ku
6 Thaçi i kërkonte LDK-së të merrte pjesë në Qeverinë e
7 Përkohshme që kishte formuar muajin e shkuar: 'Është në
8 interes të LDK-së të mos bojkotojnë institucionet e të
9 respektojnë marrëveshjen që ka nënshkruar presidenti. Është në
10 interesin e tyre të ngrihen mbi këto përçarje dhe të bëjnë
11 rekomandime.'" "

12 Dëshmitar, në këto kohë ju keni qenë ndihmës-ministër i
13 mbrojtjes, në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, a e keni ditur
14 që z. Thaçi bëri, i bëri thirrje LDK-së ndonëse ata nuk
15 merrnin pjesë në atë kohë, u kërkoi të bëheshin pjesë e vijoi
16 t'u kërkonte të bëheshin pjesë e Qeverisë së Përkohshme të
17 Kosovës?

18 PË. Po.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kërkohet që
20 të pranohet ky dokument.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
22 [Përkthim] Na jepni ERN-në ju lutem.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] DHT04018 deri në DHT04028
24 anglishtja, dhe DHT04022 deri në DHT02022 [Sipas përkthimit]
25 në shqip.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 [Përkthim] Dokumenti pranohet.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Vërej që
4 anglishtja ka vetëm një faqe. DHT04022 deri DHT04022. Ju
5 kërkova ndjesë, desha të thoja shqipja. Anglishtja është
6 DHT04018 deri në DHT04028. A doni që të pranohet i gjithë
7 dokumenti apo vetëm faqet përkatëse?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull, atëherë.
10 Materiali DHT04018-DHT04028 në anglisht dhe materiali përkues
11 në gjuhën shqipe me DHT040022 [Sipas përkthimit] do të marrë
12 numrin e provës materiale 1D00168, dhe klasifikimin aktualisht
13 e ka publik.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Dëshmitar, javën e kaluar ju thatë që keni qenë i
16 pranishëm në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm ku u zgjodh
17 edhe kryeministri i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, kështu?
18 PË. I njëjti takim kur ka qenë, ka informu që atëherë është
19 bë edhe kjo, deklarimi se a do të jetë z. Thaçi apo kush
20 kryeministër.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Shohim në ekran provën
22 materiale P00645, dhe fillojmë në faqen 672, që është faqja e
23 dytë e dokumentit.

24 PY. Shohim nga fillimi, ku thotë këtu, "Rexha", që është
25 komandant Drini, në fakt, pika e fundit, këtu thuhet sikur ai

1 ka thënë që:

2 "Ramushi ... këmbëngul që Sylejman Selimi duhet të jetë
3 Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së!!!"

4 Folësi i radhës është Sokol Bashota, dhe ai thotë:

5 "Shpresoj dhe unë uroj, dëshiroj, që ky puç të mos jetë
6 bërë nga UDB-ja. Burimet janë ogurzeza", thuhet këtu.

7 A ju kujtohen këto shkëmbime në këtë takim?

8 Po e përfundoj, ku komandant Rexha -- shkojmë pak më
9 poshtë tek shqipja, ju lutem. Komandant Rexha, ka thënë:

10 "Është zgjedhur Syla", domethënë Sylejman Selimi, "për
11 shkak se mund të keqpërdoret më së lehti!"

12 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj sepse i ka dhënë
13 ngjyrim mënyrës se si është komunikuar.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Në rregull, kush është folësi atëherë, Dëshmitar?

16 PË. Nuk po e di cili takim është ky, por që këtu bëhet --
17 Sokoli, Daja. Në këtë takim s'kam qenë. Ky takim mund të ketë,
18 të është bërë në mars, nuk po -- marsi, ku e di unë.

19 PY. Besoj se është takimi i 26 shkurtit ku ju thatë se keni
20 qenë. Ja, shohim faqen tjetër të dokumentit, se tregohet dhe
21 se si janë bërë votimet. Edhe sipas këtij teksti, ju keni
22 thënë që jeni i pavendosur, por që keni zgjedhur të jeni pjesë
23 e shumicës, të bëni si shumica. Është i njëjti takim.

24 PË. Në rregull.

25 PY. Tani i kthehem faqes pararendëse. Atëherë, kush është

1 Rexha?

2 PË. Rexha mbiemrin e ka pas komandant Drini, por Rexha dhe
3 emrin e ka edhe Rexhep Selimi tash. Cili prej tyre? Por takim
4 më 26 është i saktë që është mbajtur. Është me -- janë bo
5 diskutimet e aty, por tash s'më kujtohen të gjitha diskutimet
6 të cilat si janë bo, se nuk kemi qenë veç ne aty, por kanë
7 qenë edhe komandantë të zonave edhe të Shtabit të
8 Përgjithshëm, kanë qenë goxha shumë njerëz aty. Këto nuk muj
9 me i kuptu, me i mbajt mend të gjitha këto bisedat, por Drini
10 është e vërtetë që kështu ka deklaruar.

11 PY. Kështu ka thënë Drini. Në rregull. Sokol Bashota thotë që
12 zgjedhja e Sylejman Selimit -- ose më saktë, ai uron të mos
13 ketë qenë një puç i planifikuar nga UDB-ja. Ju kujtohet ta
14 ketë thënë ai këtë?

15 PË. Po, po.

16 PY. Ju thoni, këtu thuhet që Drini ka thënë:

17 "Syla është zgjedhur se mund të manipulohet më lehtë",
18 pra "shumë lehtë", kështu?

19 PË. Po, po ashtu është. Q'ashtu ka thënë ai.

20 PY. Atëherë, a është e drejtë të themi që dhe Sokol Bashota
21 dhe Drini ishin kundër emërimit të Sylejman Selimit si
22 komandant të përgjithshëm?

23 PË. Po, faktikisht, po.

24 PY. Pak kohë pas këtij takimi, Sylejman Selimi zëvendësoi në
25 fakt komandant Drinin si komandant të zonës së Pashtrikut,

1 kështu?

2 PË. Po, më vonë.

3 PY. A e dini nëse motivi i Sylejman Selimit mund të ketë
4 qenë, pjesërisht, i mbështetur për faktin që Drini kishte
5 kundërshtuar emërimin e tij si komandant të përgjithshëm, a e
6 dini diçka të tillë?

7 PË. Jo.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë dhe të shohim
9 pjesën ku ka folur Çeliku. Në shqip duhet të jetë faqja e
10 radhës.

11 PY. Çeliku, kush është?

12 PË. Fatmir Limaj.

13 PY. Z. Limaj ka thënë:

14 "Ky Shtab ka arritur maksimumin e internacionalizimit të
15 çështjes së Kosovës."

16 A mund të na e shpjegoni ju si e keni kuptuar këtë fjali,
17 çfarë ka dash të thotë ai me këtë?

18 PË. Po, me këtë ka dash të thotë që Shtabi i Përgjithshëm në
19 aspektin ndërkombëtar edhe me ndërkombëtarët për të treguar se
20 kush është UÇK-ja, dhe pse lufton. Që kjo me veprimin e saj të
21 deritanishëm ka arritur aq sa ka arrit deri këtu, ky moment që
22 ka mbërrit, dhe kaq ka mund, ma tepër nuk ka mujtur të arrin
23 si shtab.

24 PY. Kur thotë ai "internacionalizim", ju si e kuptoni këtë
25 fjalën "internacionalizim", çfarë ka dash të thotë ai me këtë

1 term?

2 PË. Tash, mendimet e, çdonjëri i ka ndryshe, me
3 internacionalizimin në këtë aspekt në atë kohë është thënë në,
4 aspektit të internacionalizimit, domethënë të njohurisë të
5 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në aspektin internacionale të
6 dihet se kush është dhe për çka lufton. Qëllimi i saj është
7 liria e Kosovës dhe pavarësia e Kosovës.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tek faqja tjetër.

9 PY. Dëshmitar, ky mendohet se është një procesverbal i
10 diskutimeve që janë bërë për të zgjedhur kryeministrin. Po të
11 shohim këto shënime, duket sikur pesë persona kanë qenë nga
12 nëntë personat të pranishëm, pesë kanë qenë pro z. Thaçi, dy
13 për z. Krasniqi, dhe dy të pavendosur. Ndonëse ju vetë keni
14 thënë që unë do bëj si shumica, kështu?

15 PË. Po, kam thanë, si shumica.

16 PY. Tani, nëse pesë nga nëntë persona kanë mbështetur z.
17 Thaçi, përpara këtij takimi, nuk ka qenë e paravendosur që të
18 do zgjidhej automatikisht z. Thaçi, apo jo?

19 PË. Po nuk ka qenë e përcaktuar, është e vërtetë, veç
20 përcaktimi i udhëheqësit të delegacionit u dit që do të, duhet
21 të jetë Thaçi.

22 PY. Sa i -- tani, kur u krijua Qeveria e Përkohshme në prill,
23 a e dini ju sa herë takohej Qeveria e Përkohshme e Kosovës në
24 cilësinë e saj si një qeveri e re?

25 PË. Jo, nuk kam pas [E pakuptueshme]. Sidomos nga periudha

1 kur kam qenë në operacionin Shigjeta deri pastaj dhe pas
2 përfundimit të luftës kam punue në Komisionin për
3 Infrastrukturë dhe nuk kam pas kohë të merrem me to ose sa
4 herë mblidhen ose, ose -- ardhjet e shpeshta apo e rrallët.
5 PY. A e dini nëse Qeveria e Përkohshme mbajti ndonjëherë
6 ndonjë takim qeveritar?

7 PË. Jo, nuk e di.

8 PY. A keni dijeni se ku anëtarët e ndryshëm të Qeverisë së
9 Përkohshme ndodheshin fizikisht, pas fillimit të bombardimeve
10 të NATO-s? Ndodheshin, ishin të gjithë në Kosovë, të gjithë në
11 Shqipëri apo dikush -- në Kosovë e dikush në Shqipëri?

12 PË. Po në atë kohë nuk ishin me një vend, ishin të shpërndarë
13 në shumë vende. Edhe në, disa në Kosovë, disa në Shqipëri,
14 disa jashtë.

15 PY. Dua t'ju sjell në vëmendje tani fillimin e fushatës së
16 bombardimit të NATO-s, bombardimeve të NATO-s, ju dëshmëtuat
17 që në nëntor të vitit 1998 filluat organizimin me përpjekjen
18 për ta bërë UÇK-në një organizatë më profesionale. Pyetja që
19 kam është kjo, çfarë i ndodhi zhvillimit të UÇK-së si
20 organizatë në momentin kur filluan bombardimet e NATO-s dhe
21 kur filloi dhe ofensiva e pranverës e serbëve?

22 PË. Me fillimin e bombardimeve të NATO-s dhe fillimi i
23 ofensivave serbe të njëjtën kohë, atëherë dhe që dhe sistemi,
24 faktikisht, përpjekjet tona që ishin të -- strukturojmë
25 aspekte ushtarake nuk mund të qëndronte të njëjtë për arsye se

1 edhe ofensivës që u zhvillojshin në atë kohë, territorit dhe
2 mundësitë që nuk kishim, që ajo të ishte kompakte dhe të ketë
3 një sistem, po të shumtën edhe u dëmtue edhe aspekti edhe i
4 komandimit edhe i udhëheqjes të këtyne njësive, për arsye të
5 ofensivave të rrepta që ishin, ishim në atë kohë.

6 PY. Po mundësia e komunikimit midis Shtabit të Përgjithshëm
7 me komandantët e zonave, a u ndikua funksionimi i komunikimit
8 midis Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantëve të zonave?

9 PË. Po. Ishte vështirësi me komunikim pa marrë parasysh pse
10 dhe i kishim në telefonat satelitorë, por në atë kohë gjatë
11 ofensivave ne nuk kishim mundësi çdo herë që të kishim energji
12 elektrike për t'i mbushur bateritë e tyre. U duhet të ruhen
13 dhe të kemi një komunikim sa ma pak, veç në rastet emergjente,
14 por edhe mundësinë e komunikimit, siç ishte mundësia e
15 mëhershme nuk e kishim, për arsye se veç ky sistem është
16 dobësuar shumë me sulmet e ashpra të forcave serbe.

17 PY. Po njësitet e UÇK-së? Qëndruan të gjitha në Kosovë?

18 PË. Në varësisht prej situatave të ndryhem të njësive të
19 cilat i kanë pasun. Por shumica e njësive po, është qëndruar
20 në Kosovë. Dhe detyra e tyre strikte ka qenë mbrojtja e
21 popullatës.

22 PY. Po anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm? A qëndruan të
23 gjithë në Kosovë deri në fund të luftës?

24 PË. Jo, për arsye se me fillimin e bisedimeve në Rambuje një
25 pjesë e shtabit veç është larguar dhe shkoi në qeverinë

1 përkohshme, pastaj u nis një pjesë tjetër gjatë ofensivës që
2 kanë dalë edhe në Shqipëri. Një pjesë ka mbetur brenda në
3 Kosovë. Kështu që si shtab nuk ka qenë, domethënë, kompakt
4 edhe gjatë kësaj kohe të bombardimeve të NATO-s brenda në
5 Kosovë.

6 PY. A jeni në dijeni të përbërjes së anëtarëve të Qeverisë së
7 Përkohshme?

8 PË. Jo të gjithë, një pjesë.

9 PY. A kishit dijeni se disa prej atyre ishin anëtarë të
10 partive të ndryshme?

11 PË. Po.

12 PY. Sa anëtarë të Qeverisë së Përkohshme i keni pa me sytë
13 tuaj, pra faktikisht, që po qëndronin në Kosovë?

14 PË. Po, anëtarët e Qeverisë së Përkohshme në atë kohë, folim
15 për periudhën prill, kanë qenë pak ata që kanë qenë brenda.
16 Grup shumë i vogël.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të nxirret në ekran dokumenti
18 me numër P1401, ju lutem, në faqen 291, si në versionin në
19 anglisht ashtu dhe në shqip.

20 PY. Dhe ndërkohë që presim sa të dalë në ekran, Dëshmitar,
21 shumë, mijëra, në mos qindra mijëra shqiptarë të Kosovës ishin
22 në proces të dëbimit, pra po dëboheshin nga Kosova asokohe, a
23 është kështu?

24 PË. Po, po. Ashtu është. Me qindra mijëra.

25 PY. Ka pasur kjo ndonjë ndikim, pra ky dëbim i qindra

1 mijërave shqiptarëve në strukturën e njësive të UÇK-së, dhe
2 nëse po, çfarë ndikimi ka pasur?

3 PË. Po, dhe dëbimi edhe lëvizja e popullatës civile ka pas te
4 njësitë, sidomos një pjesë e njësive është dasht, për
5 shembull, gjatë dëbimit të ndihmon ose faktikisht të mirret me
6 popullatën civile. Dhe kështu që edhe disa pjesë të ushtarëve
7 kanë shku mbrapa familjeve të tyre. Kështu që ka pas edhe kjo
8 një ndikim te njësitë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

9 PY. Dëshmitar, në ekran shihni shtëpinë të cilën besoj se e
10 keni identifikuar në përgjigje tuaja ndaj pyetjeve të
11 Prokurorisë si shtëpia që ishte selia e Qeverisë së
12 Përkohshme, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. A keni, a keni parë ndonjëherë Qeverinë e Përkohshme që
15 të zhvillonte ndonjë mbledhje në këtë shtëpi?

16 PË. Jo gjatë kësaj periudhe.

17 PY. A e dini se kush ka qëndruar në këtë shtëpi?

18 PË. Nuk muj me dit saktë kush kanë qëndru në [E
19 pakuptueshme]. Nji herë në fillim në nëntor kam qenë edhe unë,
20 pak, derisa jam mbajtur në [E pakuptueshme]. Pastaj kush kanë
21 qëndru krejt, nuk e di.

22 PY. E kisha konkretisht për periudhën prill-maj. Pra, ju po
23 thoni që nuk e dini se kush ka qëndruar aty në atë kohë?

24 PË. Jo, jo.

25 PY. Tani të flasim tani diçka për, që i keni treguar ZPS-në

1 në 2019, dhe ju është bërë kjo pyetje në Pjesën 11, faqja 20,
2 në anglisht, në rreshtin 7, ju është bërë kjo pyetje:

3 "Pra, e kam kuptuar saktë që Qeveria e Përkohshme bënte
4 një kontroll mbikëqyrës politik?".

5 Ndaj UÇK-së bëhet fjalë në këtë rast. Dhe përgjigjja juaj
6 është kjo:

7 "Sipas rregullave kështu duhet të kishte qenë, por nuk e
8 di se deri ku kanë arrit me e bo një gjë të tillë."

9 Pyetja që kam unë është kjo, pse keni ju dyshime nëse
10 Qeveria e Përkohshme mund të bënte një mbikëqyrje faktikisht
11 mbi UÇK-në?

12 PË. Nuk është çështja e vetëm dyshimit, se edhe mundësia nuk
13 është lejuar që ka mujt në atë kohë që Qeveria e Përkohshme të
14 ketë një ndikim. Shumë problem ka qenun që Shtabi i
15 Përgjithshëm të ketë një ndikim në njësitë, leje mo Qeveria e
16 Përkohshme e cila ishte veç në fillim të formimit, për arsye
17 të ofensivave të rrepta që ishin, lëvizjet e forcave tona. Dhe
18 normalisht dhe mundësia e komunikimit me njësitë dhe më poshtë
19 nuk ka mujt të jetë as nga shtabi, por as nuk ka mujt që të
20 ketë ndikim edhe Qeveria e Përkohshme në atë kohë. Folim për
21 periudhën, unë me sa di, domethënë, kohën prej prill, maj, në
22 atë drejtim. Faktikisht, prilli kur unë kam qenë brenda.

23 PY. Pyetja tjetër që ju është bërë ka qenë edhe më konkrete.
24 Për diçka më konkrete. Fillon në rreshtin 13 -- 14.

25 "... Sylejman Selimi", është pyetja kjo, "Sylejman Selimi

1 si komandant i përgjithshëm a i raportonte Hashim Thaçit, duke
2 qenë se ky tani ishte kryeministër?”.

3 Dhe ju kësaj pyetjeje i jeni përgjigjur kështu:

4 “Sipas rregullave po, do të duhej që t’i raportonte, por
5 nuk e dija a ka pas mundësi apo jo që t’i raportonte.”

6 A mund të shpjegoni përse ju nuk e dini nëse ai ka pas
7 mundësi që t’i raportonte Hashim Thaçit?

8 PË. Për arsye se në këtë kohë kur folim a ka mujt me raportu,
9 se krejt kur jemi pa me z. Thaçi jemi pa në prill, në zonën e
10 Nerodimës, faktikisht, në zonën operative të saj, diku në
11 q’atë kohë kam qenë edhe unë, jam taku me z. Thaçi. Po me z.
12 Sylaj unë, takimi i tij ka qenë shumë më vonë. Kur ka ardh, po
13 tashti a i ka raportue a ça ka bo, nuk e di. Unë e di që deri
14 atje s’ka mujt t’i raporton, as ka mund të kontakton në
15 aspektin fizik, mendoj, brendapërbrenda në Kosovë. Se duhet
16 marrë parasysh se edhe më hershme ishin në Rambuje, marsit e
17 shkurti, nuk ka, unë çka di, që nuk ka mujtun t’i raporton për
18 çdo here shpesh.

19 PY. Thatë se ju keni hequr dorë nga posti jua si shef shtabi
20 në prill të 1999, kështu është?

21 PË. Po.

22 PY. Dhe ju thoni se pastaj shkuat të punonit si asistent,
23 ndihmësministër në Ministrinë e Mbrojtjes, kështu është?

24 PË. Po.

25 PY. Ministria bënte pjesë në Qeverinë e Përkohshme, nuk bënte

1 pjesë në UÇK, kështu është?

2 PË. Q'ashtu është.

3 PY. Pra, nuk mund të emëroheshit nga komandanti i ri i
4 përgjithshëm, nga z. Çeku, kështu është?

5 PË. Jo.

6 PY. Kjo ngaqë Qeveria e Përkohshme nuk ishte nën pushtetin e
7 tij, kështu është?

8 PË. Po, ashtu është.

9 PY. I keni dëshmuar, keni dëshmuar para ZPS-së, dhe kjo është
10 në fillim të faqes 11 -- të Pjesës 11, faqja 22, që aspektet
11 ushtarake vijuan që të mbeten pjesë e UÇK-së, dhe të ishin në
12 kontroll të shtabit, të komandantit të përgjithshëm, kështu
13 është?

14 PË. Po, ashtu është.

15 PY. Dhe, i keni thënë ZPS-së se, për shembull, kur Fatmir
16 Limaj kaloi në Ministrinë e Mbrojtjes, ai nuk kishte më në
17 dorë, por dhe nuk komandonte policinë ushtarake sepse kjo
18 vijoi që të qëndronte nën urdhrat e UÇK-së, kështu është?

19 PË. Po, ashtu është.

20 PY. Dhe a është e saktë pra, është e vërtetë se Sokol Dobruna
21 vijoi që t'i raportonte komandantit të përgjithshëm të UÇK-së,
22 z. Çeku asokohe?

23 PË. Po, derisa nuk është mbartun në Qeverinë e Përkohshme.

24 PY. T'i kthehemi tani Operacionit Shigjeta, ju ishit, ju
25 ishte ngarkuar, pra, detyra, ishit në krye të operacioneve, sa

1 i takon Operacionit Shigjeta, kështu është?

2 PË. Po, operacioneve.

3 PY. I keni thënë ZPS-së në Pjesën e 7, duke filluar në faqen
4 8, fillim të faqes 8, se në janar të vitit 1999, pas
5 konsultimeve dhe aprovimit nga zëvendëskomandantit Bashota dhe
6 komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, ju filluat përpilimin e
7 planeve për Shigjetën, kështu është?

8 PË. Po.

9 PY. A është e saktë se Shigjeta po përgatitej me muaj përpara
10 krijimit të Qeverisë së Përkohshme?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. A është e saktë se planet për Shigjetën nuk janë
13 përpiluar me urdhër të Hashim Thaçit si kryeministër?

14 PË. Po, e saktë. Nuk është.

15 PY. Plani operacional a u nënshkrua nga Sylejman Selimi si
16 komandant i përgjithshëm?

17 PË. Po.

18 PY. Ka pasur tre komanda operative të Shigjetës, sa prej
19 komandantëve të këtyre tri komandave operative keni emëruar
20 ju?

21 PË. Me këto komandat operative faktikisht emërimet nuk jam
22 marrë veç unë, por është marrë edhe shtabi, si shtab.

23 Komandantët për shembull edhe të, edhe Drejtimit 1 edhe 2
24 është marrë me propozimin tim, dhe është aprovu nga Shtabi i
25 Përgjithshëm. Normalisht është, janë emëruar ata. Emërimi i

1 tyne është bënë suazat e propozimit tim edhe komandantit të
2 përgjithshëm.

3 PY. Pra, ky komandant është komandant Çeku, kështu është?

4 PË. Jo. Më herët është bërë emërimi nga Sylejman Selimi.

5 PY. A mund t'i identifikoni me emër mund të thoni emrat, pra
6 e dy komandantëve që ju propozuat dhe u aprovuan zyrtarisht
7 nga Shtabi i Përgjithshëm, nga komandanti Sylejman Selimi?

8 PË. Po. Në zonën, Drejtimit Operativ numër 1, të Koshares,
9 Rasim Berisha, dhe i Drejtimit Operativ numër 2, Pashtrik,
10 Nexhmi Kastrati.

11 PY. Kush e ka emëruar komandantin e Drejtimit 3?

12 PË. Drejtimi 3, numër 3, është emëru nga unë, por nuk është
13 funksionu, nuk ka hy në funksion asnjherë.

14 PY. T'ju tregoj disa artikuj të shtypit, apo të lajmeve, dhe
15 t'ju pyes nëse keni dijeni për këto.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fillim, ju lutem, nxirrni në
17 ekran dokumentin nga 019775 deri në 019776 në anglisht, dhe
18 DHT04030 deri në DHT04030-AT në shqip.

19 PY. Në fillim, a është e saktë që Operacioni Shigjeta ka
20 filluar më datë 26 maj të vitit 1998 -- jo, më falni 1999?

21 PË. Si operacion nuk është 26 maj, por ka fillu më 9 prill,
22 duke filluar në Koshare, Drejtimi i parë, e më 26, Drejtimi i
23 dytë, është operativ i Pashtrikut më 26 maj.

24 PY. Pra, drejtimi i Pashtrikut. Jo, në fillim të shikojmë
25 këtë. Është një artikull i datës 27 maj ku thuhet se z. Thaçi

1 ka qenë në Paris ku është takuar me ministrin e punëve të
2 jashtme të Francës atë ditë. Ju, ndërkohë që zhvillohej
3 Operacioni Shigjeta, ishit në dijeni që z. Thaçi nuk ishte as
4 në Kosovë as në Shqipëri, por ishte në Perëndim?

5 PË. Jo, nuk isha, në dijeni.

6 PY. Ka disa artikuj që tregojnë se në periudhën të paktën nga
7 ky takim në maj deri në 3 qershor, z. Thaçi ka qenë në Londër,
8 në Bon dhe në Këln të Gjermanisë. Besoj se ju nuk keni qenë në
9 dijeni që ai ka qenë i dalë prej Kosove, prej Shqipërie në atë
10 periudhë, kështu është?

11 PË. Po, ashtu është. Nuk e di.

12 PY. Arsyeja pse jua bëra këto pyetje, Dëshmitar, se më
13 intereson të di sa i takon raportimit. Duke qenë se z. Thaçi,
14 ta supozojmë se z. Thaçi ka qenë në këto vendet që unë i ceka,
15 pra në Francë, në Angli e në Gjermani. Si, ndërkohë që ky
16 operacion po zhvillohej, Nexhmi Kastrati kujt i raportonte?

17 PË. Nexhmi Kastrati më raportonte mua, si komandant i
18 operacioneve që isha në komandë në Kukës.

19 PY. Po ju kujt i raportoni?

20 PË. Ministrin të mbrojtjes.

21 PY. Po z. Çeku kujt, kush i raportonte?

22 PË. Njëjtë ashtu dhe ne, si Operacioni 1, raport dërgojshim
23 edhe në Shtab të Përgjithshëm. Një në Shtab të Përgjithshëm
24 një tjetër në ministri.

25 PY. A dini nëse z. Çeku i raportonte z. Thaçi -- jo më falni,

1 ta them ndryshe. A e dini nëse z. Sylja i raportonte z. Thaçi?

2 PË. Jo, nuk e di.

3 PY. Dua të kalojmë tani në një dokument tjetër, të cilin jua
4 kanë treguar javën që shkoi. Ka të bëjë me dokumentin e gardës
5 kombëtare të 14 majit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fillim dua që të nxjerrim dy
7 faqet e para të këtij dokumenti të cilat nuk jua treguam, me
8 numër SPOE022 -- më falni, SPOE00228180 deri në SPOE00228181
9 në anglisht, ju lutem, Rev 2. Duhet të jetë i njëjti dhe në
10 shqip.

11 PY. Ju, dua t'ju them z. Dëshmitar, se jua kam treguar këto
12 dy faqe dhe mund, më falni, që po ju tregoj këto dy faqe të
13 para dhe mund të shikoni dhe rreshtin e faksit që, për të bërë
14 një krahasim me pjesën tjetër të dokumentit, por duket se
15 është dërguar me faks në të njëjtën kohë me faqen 3 më pas.

16 Por këtu, në këtë faqe duket që dokumenti nuk ka numër
17 protokolli, a është kështu?

18 PË. Po, saktë. Nuk ka numër protokolli.

19 PY. Dhe po të shohim faqen e parë, aty thuhet se ky propozim
20 për gardën kombëtare bëhet në bazë të propozimit, pra me
21 propozim të Shtabit të Përgjithshëm, pra është një dokument që
22 në pamje të parë duket se është propozuar nga Shtabi i
23 Përgjithshëm, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Të kalojmë tani -- jo, t'ju bëj një pyetje. Fakti se nuk

Dëshmitari: Bislim Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 24

1 ka numër protokolli, a ju thotë diçka? Pra, për faktin nëse ky
2 dokument ka qenë apo jo ndonjëherë dokument zyrtar?
3 PË. Për mua, në qoftë se nuk ka numër protokollit, nuk ka
4 nënshkrim, atëherë ky dokument nuk është, nuk ka qenë valid
5 dhe nuk është i shtinë në funksion.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që këto dy
7 faqe të pranohen në prova gjyqësore.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
9 kundërshtime?

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
12 dokumenti SPOE00228180 deri në SPOE00228181, në anglisht, Rev
13 2, dhe në përkthimin në shqip, pranohen në prova gjyqësore.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
15 provës 1D00169, aktualisht e klasifikuar si konfidencial.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj se mund të jetë publik.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
18 Riklasifikohet si publik.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tani tek prova materiale
21 me numër P01434, ju lutem.

22 PY. Dëshmitar, këtë jua kanë treguar javën që shkoi. Është
23 faqja e tretë, faktikisht, e atij dokumenti. Dhe këto, si të
24 thuash, jep organizimin e reparteve, pra të njësive të gardës
25 kombëtare. Dua që t'ju pyes, t'ju bëj disa pyetje pra, sa

1 realiste ishte kjo në maj të 1999? Për shembull, po të shohim

2 Pjesën e parë ku thuhet që:

3 "Alarmi [Sipas përkthimit] do të -- do të ketë këto
4 njësi:"

5 Pra:

6 "10 brigada të artilerisë fushore."

7 Sa artileri kishte UÇK-ja në maj të 1999?

8 PË. Asnjë hiç.

9 PY. Po të zbresim pak më poshtë:

10 "80 batalione të mbrojtjes kundër atomike, kimike dhe
11 biologjike."

12 Po ç'kapacitete kishte UÇK-ja në maj të 1999, për t'u
13 mbrojtur, ta zëmë nga sulmi atomik?

14 PË. Z. Avokat, nuk është këtu çështja që bëhet 80 batalione,
15 por Batalioni i 80-të. Emër është, i njësisë, jo 80 batalione,
16 por Batalioni i 80-të. Nji batalion është, por quhet Batalioni
17 80. Kështu që edhe kjo nuk ka mujt me në atë kohë, dhe s'ka
18 pas.

19 Unë kur e kam dorëzuar atë detyrën, këto struktura nuk kanë
20 qenë. Kjo strukturë çka po e shof është propozuar nga z. Çeku
21 që të shkon në zhvillim, ku do të shkojë zhvillimi i Ushtrisë
22 Çlirimtare të Kosovës, por kjo strukturë ka mund të zhvillohet
23 vetëm pas luftës. Nuk ka pas mundësi aspak në atë kohën e
24 ofensivave serbe, prill ose maj të 1999, që kjo strukturë të
25 bahet.

1 PY. Po, këtë desha që të nënvizoj. Për shembull, luftë
2 kibernetike, dhe orkestra frymore e ushtrisë. Besoj se këto
3 nuk janë gjëra për të cilat ju shkonte mendja në maj të 1999.

4 PË. Jo, aspak. Në atë kohë shkonte mendja si t'i mbroj
5 popullatën edhe njësitet që i kisha, e jo te riformoj e
6 strukturoj një strukturë të tillë. Kjo edhe në paqe është kohë
7 e gjatë, duhet për të arritur një qëllim vite. Tani, këtë
8 strukturë që jemi duke ndërtue si shtet, ne nuk kemi arrit ta
9 bëjmë, e leje ma ta bëjmë për një muaj ditë.

10 PY. Sylejman Selimi duhej të ishte emëruar komandant i kësaj
11 garde kombëtare. Sylejman Selimi ndodhej në Shqipëri asokohe,
12 e dini këtë?

13 PË. Po, e di atë, jam taku në Shqipëri me z. Selimi.

14 PY. Dhe a është e vërtetë se ai asokohe ishte lënduar rëndë
15 në një aksident automobilistik? Keni dijeni për këtë?

16 PË. Po, kam dijeni. Është lënduar.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, vërej orën, besoj
18 se është momenti për të bërë pushimin.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
20 tani një pushim dhjetë minutësh, Dëshmitar, si më përpara tani
21 mund të dilni nga salla. Do t'ju shoqërojë Asistentja e Sallës
22 për të dalë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një diçka për të thënë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj në

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic (Vazhdim)

Faqe 27

1 seancë private.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar,
3 ju lutem na kaloni në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
11 jemi në seancë publike.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë
13 ndërprerjen e seancës për dhjetë minuta.

14 --- Seanca ndërpritet në orën 10.02

15 --- Seanca rifillon në orën 10.15

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
17 sillni dëshmitarin në sallë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Z.
20 Zyrapi do të vazhdojmë.

21 Vazhdoni z. Misetic.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 I lutem Sekretarit të seancës të vendosë në ekran
24 materialin DHT04009 deri në DHT04017-ET në faqen 5. Në shqip
25 është SPOE00053060 deri në SPOE00053071 në faqen SPOE00053068.

1 PY. Dëshmitar, kjo është një intervistë që ka dhënë Agim Çeku
2 për gazetën Zëri, edhe doja t'ju pyes nëse përputhet edhe
3 kërkesa juaj me atë që ka thënë ai.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë te faqja 5 në anglisht.

5 PY. Poshtë, majtas tek shqipja, z. Zyrapi është bërë një
6 pyetje:

7 "Procedura e zgjedhjes suaj si shef i Shtabit të
8 Përgjithshëm të UÇK-së a është bërë në Kosovë apo më herët?"

9 Dhe përgjigja është kjo:

10 "Ne qëndruam disa ditë në Shtabin e Përgjithshëm dhe puna
11 ime u diskutua -- puna ime është diskutuar gjerë e gjatë dhe
12 vendimi që unë të emërohesha shef i shtabit të UÇK-së është
13 marrë nga i gjithë Shtabi i Përgjithshëm dhe jo nga vetë një
14 person."

15 Z. Zyrapi, unë kam këtë pyetje: A keni qenë ju i
16 pranishëm në mbledhjen e Shtabit të Përgjithshëm ku z. Çeku -
17 ju kërkoj ndjesë se thashë Zyrapi fillimisht - ku u emërua z.
18 Çeku shef i Shtabit të Përgjithshëm, keni qenë pra ju i
19 pranishëm?

20 PË. Po, kam qenë se në të njëjtën kohë unë kam dorëzuar detyrën
21 ai ka marrë detyrën e shefit të shtabit.

22 PY. Pra, ka të drejtë ai kur thotë që emërimi i tij është
23 bërë prej Shtabit të Përgjithshëm në tërësi?

24 PË. Po.

25 PY. Ai nuk thotë që është emëruar nga Qeveria e Përkohshme. A

1 ju kujtohet edhe ju kështu?

2 PË. Po në atë takim ka qenë Shtabi i Përgjithshëm ku unë kam
3 bo dorëzimin e detyrës, edhe ai ka marrë atë detyrë.

4 PY. Diskutojmë për një çast për z. Çeku. Ju thatë që urdhrin
5 për Operacionin Shigjeta, fazën e parë në prill e ka firmosur
6 Sylejman Selimi, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. A do të thotë kjo që Sylejman Selimi kishte edhe
9 autoritetin si komandant i përgjithshëm ta ndalonte
10 Operacionin Shigjeta nëse dëshironte? A e keni kuptuar ju
11 kështu rolin e tij?

12 PË. Po.

13 PY. Flasim për fazën e dytë në fund të majit. Tani komandanti
14 i përgjithshëm i UÇK-së është z. Çeku. Po z. Çeku a kishte
15 autoritetin ta fillonte e ta ndalonte Operacionin Shigjeta në
16 këtë periudhë kohore?

17 PË. Po.

18 PY. Kështu e keni kuptuar edhe asokohe?

19 PË. Ashtu e kam kuptuar asokohe dhe ashtu është edhe me
20 rregulla ushtarake.

21 PY. A e keni ditur natyrën e marrëdhënieve mes z. Çeku, si
22 komandant i përgjithshëm dhe z. Sylja si ministër i mbrojtjes?
23 Pra, çfarë dua të them unë është a ishte e qartë se kush ishte
24 komandanti i këtij operacioni, kush e drejtonte këtë operacion
25 dhe çfarë marrëdhënie kishin ata me njëri-tjetrin? E keni

1 ditur ju atë kohë?

2 PË. Atë marrëdhënie çfarë i kanë njëri me tjetrin nuk i di se
3 z. Çeku ka qenë mbrenda në Kosovë e z. Sylja ka qenë në
4 Shqipëri. Kështu që marrëdhëniet të aspektit profesionale janë
5 mbajt edhe z. Çeku i ka raportuar z. Sylja, por ndodhitë brenda
6 që kanë ndodhur në Kosovë. Marrëdhënie të tjera nuk di ç'ka
7 kanë mujt me pas.

8 PY. Unë përpiqem të kuptoj këtë gjë, dhe mbase kuptova diçka
9 nga përgjigja juaj e fundit, por unë po përpiqem të kuptoj
10 këtë: Ju si ndihmësministër, përgjegjës për operacionin keni -
11 - pra, keni qenë ju përgjegjës për operacionin dhe jo z. Çeku,
12 të paktën për drejtimin e këtij operacioni, sepse ju ishit në
13 Shqipëri dhe e komandonte ai në Kosovë këtë operacion dhe jo
14 z. Sylja në Shqipëri? Apo çfarë, se s'po e kam të qartë?

15 PË. Sa i përket operacionit ose operacioneve në Shqipëri i
16 kam udhëheq edhe unë. Po unë normalisht i kam raportue
17 ministrit të mbrojtjes po edhe një raport i ka shku z. Çeku.
18 Kështu që operacionet i kam komandu unë në Shqipëri. Brenda ka
19 komandue Shtabi i Përgjithshëm, z. Çeku.

20 PY. E qartë. Faleminderit. Kam një pyetje lidhur me hartat që
21 pamë për zonat që kishin brigadat e ndryshme.

22 A ka dallim për shembull -- ose ndryshe, a mund të na e
23 shpjegoni ku e kishte brigada zonën, ç'ka do të thotë a ishte
24 brigada në kontroll të plotë të zonës apo brigada ishte
25 thjeshtë e pranishme në zonë? Nuk e di a e kuptove pyetjen

1 time?

2 PË. Ndarjen e zonave ose zonat brenda një zonës operative
3 ndahet nga ana e zonës operative dhe çdo brigadë e ka pas
4 zonën e vet të përgjegjësisë dhe normalisht në atë zonë është
5 përcaktu nga e zonës operative, dhe përgjegjësia e tyre ka
6 qenë si brigadë. Ka mujt me qenë edhe njësitë mund të kenë
7 qenë njësi tjetër, jo e asaj zone, po edhe ajo në qoftë se ka
8 qenë e vendosur në atë zonë, atëherë e ka pas zonën e saj të
9 përgjegjësisë, por normalisht gjithnjë ka shku në koordinim me
10 komandant e asaj zone që është përgjegjës.

11 PY. Në fakt nuk e formulova mirë pyetjen dhe ju kërkoj ndjesë
12 për këtë. Pyetja ime ishte kjo: Në momentin që është
13 përcaktuar zona e përgjegjësisë së një brigade a do të thotë
14 kjo që forcat serbe -- jo do ta bëj edhe një herë. Jo, do ta
15 perifranoj.

16 A do të thotë kjo që zona ishte e mbrojtur tani nga
17 serbët, nga forcat serbe e rrjedhimisht në atë zonë nuk do të
18 kishte të pranishme forca serbe?

19 PË. Vartësisht që zonat janë përcaktue në hartë, mirëpo në
20 terren nuk ka qenë njëjtë situata për shkak se arsye se të
21 gjitha zonat e përgjegjësive të brigadave apo të zonave nuk
22 kanë qenë nën kontrollin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E
23 ka dhënë për shembull tjetër.

24 Marrim Prizren, zonën Prizren, është e Brigadës 125, por
25 nuk do me thonë që krejt kontrollin e ka pas Brigada 125, e ka

- 1 pas veç një pjesë të saj, ku ka qenë vetë prezent. Pjesën
2 tjetër kanë qenë serbët ose kanë qenë njësi të tjera.
3 PY. Faleminderit. Tani dua të fokusohemi tek Shqipëria. Nga
4 prilli deri në qershor 1999 ju keni qëndruar në Shqipëri.
5 Saktë?
6 PË. Saktë.
7 PY. Gjatë kësaj periudhe kohore keni vizituar edhe bazat që
8 përdorëshin për stërvitje në Shqipëri. Kështu?
9 PË. Po, saktë.
10 PY. Këtu përfshi edhe baza e Kukësit, apo jo?
11 PË. Baza e Kukësit nuk ka qenë bazë stërvitore, po bazë e
12 logjistikës.
13 PY. I keni thënë ZPS-së që gjatë kohës që keni qenë atje, dhe
14 kjo është e reflektuar në Pjesën 12, faqja 14, keni thënë që
15 kur keni qenë atje as keni parë persona të ndaluar, dhe as
16 keni parë ndonjë ambient që të përdorej për këtë qëllim.
17 Kështu?
18 PË. Po, saktë.
19 PY. Në Pjesën 12, faqja 15, i keni thënë ZPS-së që gjatë të
20 gjithë qëndrimit tuaj në Shqipëri nuk keni dëgjuar asnjëherë
21 që të jetë ndaluar njeri në Kukës apo të jetë arrestuar,
22 kështu?
23 PË. Po, saktë.
24 PY. I keni thënë ZPS-së në Pjesën 12, faqja 15, se nuk keni
25 pasur dijeni të ketë pasur burgje në Shqipëri, kështu?

1 PË. Po, kështu është.

2 PY. Gjithashtu keni vizituar edhe bazën e Cahanit. Saktë?

3 PË. Saktë.

4 PY. I keni thënë ZPS-së, Pjesa 12, faqja 22, se ju kujtohet
5 të ketë qenë një rast ndalimi në Cahan, kështu?

6 PË. Po, ashtu është.

7 PY. Ky person quhej Tomorr Buza, kështu?

8 PY. Kjartë.

9 PY. Dhe bashkë me komandant Plakun ju keni ndërhyrë që ta
10 lironin Tomorr Buzën, kështu?

11 PY. Po, kam ndërhyrë edhe e kemi liru.

12 PY. I keni thënë ZPS-së që nuk ju kujtohet asnjë rast tjetër
13 kur të ketë pasur persona të ndaluar.

14 PË. Po, ashtu është.

15 PY. Nëse ju nuk kishit dijeni që të ketë pasur persona të
16 ndaluar, a është e saktë të themi që nuk keni se si t'i keni
17 kaluar -- t'i keni përcjellë informacione Azem Syla apo z.
18 Thaçi për persona të ndaluar kur nuk keni pasur dijeni për
19 diçka të tillë?

20 PË. Po, e saktë. Ashtu është.

21 PY. Tani do flasim për një temë tjetër që ka të bëjë me
22 stërvitjet. Do kthehemi në vitin 1998. I keni thënë ZPS-së,
23 Pjesa 14, faqja 2, se gjatë kohës që ishit në Shqipëri e
24 prisnit të merrnit miratim për të hyrë në Kosovë në pranverën
25 e 1998, keni përgatitur -- keni stërvitur disa ushtarë,

1 kështu?

2 PË. Kështu është.

3 PY. Këto ishin kryesisht stërvitje taktike?

4 PË. Po, këto ishin stërvitje edhe të përdorimit të armës,
5 edhe lëvizje taktike.

6 PY. Më pas, në Pjesën 14, faqja 4, keni thënë se në janar dhe
7 shkurt të 1999 nuk kuadër të përpjekjeve për të riorganizuar
8 UÇK-në keni organizuar edhe stërvitje, trajnime, kështu?

9 PË. Po, kështu është.

10 PY. I keni thënë ZPS-së se gjatë këtyre stërvitjeve të
11 komandantëve të batalioneve - Pjesa 14, faqja 4 e intervistës
12 - ju keni thënë, citoj:

13 "Kemi përdorur dhe broshurat e Kryqit të Kuq Ndërkombëtar
14 ku shpjegohej se si duhet të sillet një komandant dhe një
15 ushtar gjatë luftës dhe çfarë të drejtash kanë."

16 Saktë?

17 PË. Saktë.

18 PY. Ideja ishte që të përgatiteshin komandantët e batalioneve
19 të cilët më pas do t'ua përcillnin dijen e tyre ushtarëve të
20 batalioneve, kështu?

21 PË. Po, kështu është.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tani në ekran provën
23 materiale P00631.

24 PY. Dëshmitar, dokumenti që keni përpara në ekran, a është
25 urdhëresa që keni lëshuar ju për stërvitjen e komandantëve të

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdim)

Faqe 36

1 batalioneve?

2 PË. Po.

3 PY. Në Shënim Përgatitor numër 2, paragrafi 3, keni thënë se:

4 "Stërviçja ishte për komandantë të batalionit sepse 80
5 për qind e tyre nuk kishin formim të duhur ushtarak."

6 Kështu?

7 PË. Po, kështu është.

8 PY. A mund të na thoni çfarë deshët të arrinit ju me këtë
9 stërviçje, me këtë përgatitje?

10 PË. Me këtë stërviçje ose trajnim kemi dasht të arrisim që
11 bash komandantët të cilët ishin të vendosur të batalioneve të
12 aftësojmë në aspektin komanduese të udhëheqjeve të
13 batalioneve, të kenë një njohuri ushtarake si përdoren njësitë
14 taktike dhe të ketë një njohuri të tyre bazike që mund të
15 udhëheqë jo veç batalionet po më vonë edhe brigadat.

16 PY. I keni thënë ZPS-së, Pjesa 14, faqja 4, se në kuadër të
17 këtij trajnimit të komandantëve të batalioneve edhe Sokol
18 Dobruna ka dhënë trajnim juridik, dhe e gjitha kjo ishte në
19 kuadër të përgatitjes së komandantëve të batalioneve, kështu?

20 PË. Po, e saktë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirë. Shohim tani provën materiale
22 me numër P01361.

23 PY. Dëshmitar, z. Zyrapi, këtë dokument a e keni parë
24 ndonjëherë më përpara? Ju kujton gjë? Dhe a e dini nëse është
25 përdorur ky nga Sokol Dobruna gjatë përgatitjes së

1 komandantëve?

2 PË. Nuk jam i sigurt, po e di që ka mbajtur ligjëрата z.

3 Dobrura. Po a është ky dokument nuk e di. Po shifet simbas saj

4 që -- simbas dokumentit, po, duhet t'i ketë përdorur.

5 PY. Në Pjesën 14, faqja 6, i keni thënë ZPS-së se z. Dobruna

6 ju ka thënë ju personalisht se kishte përgatitur tekste si

7 kodi penal, kodi i procedurës penale për rregullimin e

8 procedurave të gjykatës ushtarake, kështu?

9 PË. Në atë kohë më ka thënë që ka përgatit një pjesë të

10 dokument -- një listë të dokumentacioneve, unë nuk i kam pa.

11 PY. Edhe një gjë për një përgjegje që dhatë para pushimit sot

12 në mëngjes. Ju thatë që Sokol Dobruna ishte në UÇK, i

13 raportonte Shtabit të Përgjithshëm derisa është bartur në

14 Qeverinë e Përkohshme të Kosovës. A dini ndonjë arsye për

15 kundërshtimin e z. Dobruna se ai i është bashkuar Qeverisë së

16 Përkohshme në tetor 1999?

17 PË. Jo, nuk -- nuk kam kundërshtime.

18 PY. Të kalojmë tani tek çështja e komunikatave. I keni thënë

19 ZPS-së në Pjesën 5, faqja 7, se nuk e dini se kush i shkruante

20 komunikatat se nuk ishte në përgjegjësinë tuaj. Kështu është?

21 PË. Po, kështu është.

22 PY. T'i kthehemi tani marrëdhënies së UÇK-së me LDK-në. I

23 keni thënë ZPS-së se kur jeni kyçur ju në UÇK nga fundi i

24 majit 1998 deri në shtator 1998 keni vërejtur se stafi lokal

25 dhe ushtarët ishin më së shumti nga LDK-ja. Është në Pjesën 3,

1 faqja 31 të intervistës tuaj me ZPS-në. A është kështu?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. Gjatë kohës së qëndrimit tuaj në UÇK dhe sidomos në nivel
4 të Shtabit të Përgjithshëm, a do të kishit thënë se UÇK-ja dhe
5 Shtabi i Përgjithshëm ishin të hapur që të mirëprisnin edhe
6 ish-profesionistë të armatës jugosllave dhe ish-anëtarë të
7 FARK-ut në UÇK?

8 PË. Po.

9 PY. Do t'ju lexoj tani një listë komandantëve të UÇK-së dhe
10 do t'ju pyes nëse kanë qenë ish-oficerë të UÇK-së. Mund të
11 përgjigjeni me "po" ose "jo".

12 Skënder Hoxha?

13 PË. Po. Epror.

14 PY. Kadri Kastrati.

15 PË. Po.

16 PY. Komandant Drini?

17 PË. Po.

18 PY. Mahir Sinani?

19 PË. Gabim, emri, mbiemri.

20 PY. Ndjesë. Mbase është faji im.

21 Rifat Sylejmani?

22 PË. Po.

23 PY. Nehat Basha?

24 PË. Po.

25 PY. Gëzim Hazrolli?

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Mistic (Vazhdim)

Faqe 39

- 1 PË. Po.
- 2 PY. Mark Shala?
- 3 PË. Po.
- 4 PY. Agim Çeku?
- 5 PË. Po.
- 6 PY. Naim Maloku?
- 7 PË. Po.
- 8 PY. Sali Veseli?
- 9 PË. Po.
- 10 PY. Agim Qela?
- 11 PË. Po.
- 12 PY. Gëzim Ostreni?
- 13 PË. Po.
- 14 PY. Aziz Hyseni?
- 15 PË. Po.
- 16 PY. Kemajl Shaqiri?
- 17 PË. Po.
- 18 PY. Hysni Ahmeti?
- 19 PË. Po.
- 20 PY. Enver Oruqi?
- 21 PË. Po.
- 22 PY. Shaban Dragaj?
- 23 PË. Po.
- 24 PY. Ramë Arifaj?
- 25 PË. Po.

1 PY. Idriz Shabani?

2 PË. Po.

3 PY. A ka dhe anëtarë të tjerë, oficerë -- ish-oficerë të
4 tjerë të armatës jugosllave të cilët janë pranuar në UÇK dhe
5 që nuk janë pjesë e kësaj liste që unë sapo jua lexova?

6 PË. Po, ka.

7 PY. Mund të na i identifikoni me emër, ju lutem?

8 PË. Nuredim Ibishi, Kurtesh Fondaj, Agim Kuqi, Nebih
9 Krasniqi. Pastaj kemi Rustem Tetën, Shemsedin Cekun dhe kemi
10 -- këta janë që kanë qenë që nga fillimi edhe deri në fund. Ka
11 pas edhe tjerë. Ka pas edhe të tjerë por tash për momentin të
12 gjithë emrat nuk mund t'i mbaj mend.

13 PY. A ju kujtohet ndonjë rast i një ish-oficeri të AKJ-së të
14 cilit i është mohur -- pra, nuk është pranuar, të themi, kyçja
15 në UÇK.

16 PË. Jo, asnjë.

17 PY. Sa ish-oficerë të ushtrisë së Shqipërisë janë pranuar në
18 UÇK?

19 PË. Po ka pas edhe oficerë të Shqipërisë.

20 PY. Tahir Sinani?

21 PË. Po.

22 PY. Dikush tjetër që mund ta identifikoni me emër?

23 PË. Shpëtim Golemi, ose ndryshe Dilaver Goxhaj, Bardhyl
24 Tahiri, të cilët kanë qenë -- Adem Shehu. Këta janë [E
25 pakuftueshme] që kanë qenë nga fillimi brenda për brenda.

1 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetiç,
2 mund të keni bërë ndonjë gabim vetë kur keni filluar listën e
3 gjatë. Keni thënë:

4 "Do t'ju lexoj tani listën e komandantëve të UÇK-së të
5 cilët -- do t'ju pyes nëse kanë qenë ish-anëtarë të UÇK-së."

6 Besoj se tjetërkund e kishit fjalën.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, po, është -- ka bërë shumë
8 gabime sot. Po e kisha fjalën që kanë qenë ish-oficerë të APJ-
9 së.

10 PY. Por, a mund të konfirmoni për procesverbal që e kuptuat
11 që pyetja ime ishte "Nëse këto kanë qenë ish-oficerë të
12 armatës jugosllave"?

13 PË. Unë përkthimin e pata mirë. Më pyetët për ish-oficerët e
14 armatës që kanë qenë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës edhe
15 ashtu e kam kuptu dhe ashtu ka qenë në gjuhën shqipe të
16 paktën.

17 PY. Faleminderit, Dëshmitar. I keni thënë ZPS-së në faqen 10
18 -- në Pjesën 10, në faqen 30 në intervistën me ZPS-së se sipas
19 çmuarjes tuaj 80 për qind e UÇK-së vinte nga LDK-ja, i
20 përkiste LDK-së. A është kështu?

21 PË. Po, saktë.

22 PY. Dhe keni vijuar të thoni kështu, dhe po citoj:

23 "Nuk kam pa ndonjë problem ku njerëzit që kanë qenë
24 kundër të tjerëve të kenë qenë në LDK apo të kishin, si të
25 thuash, prejardhjen nga LDK-ja. Për shembull, Ramë Buja ishte

Dëshmitari: Bislum Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç (Vazhdim)

Faqe 42

1 anëtar i LDK-së."

2 A është kështu?

3 PË. Po, kështu është.

4 PY. Jakup Krasniqi ka qenë anëtar i LDK-së, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Dëshmitar, të vijoj me temën e LDK-së. Ju ka treguar ZPS-
7 ja një dokument që pretendohet se e ka përpiluar Gani Krasniqi
8 sa i takon degës së LDK-së në Malishevë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, nuk e kam -- nuk e kam
10 numrin.

11 PY. Pra, ju është bërë pyetje për këtë në intervistën tuaj me
12 ZPS-së dhe ju jeni përgjigjur se nuk e njihni dokumentin.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Sekretar i Gjykatës ta vendosim
14 këtë dokument në ekran, 1D6, ju lutem.

15 PY. Për procesverbal e keni diskutuar këtë në intervistën
16 tuaj me ZPS-në në Pjesën 3, faqe 34.

17 Ju rikujtohet ta keni parë këtë dokument gjatë
18 intervistës tuaj me ZPS-në?

19 PË. Ndoshta po, por diçka që -- po, dokumentin kështu e kam
20 pa, po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në pjesën e
22 poshtme të faqes që ta shohë dëshmitari nënshkrimin.

23 PY. E shihni që është nënshkruar nga Gani Krasniqi?

24 PË. Po.

25 PY. I keni thënë ZPS-së se nuk ka mundësi që ky dokument të

1 ketë ardhë prej Shtabit të Përgjithshëm. Kështu është?

2 PË. Po, kështu është. Është e vërtetë.

3 PY. Dhe a është e vërtetë që ky është një dokument i nxjerrë,
4 pra që ka dalë nga komuna, jo nga Shtabi i Përgjithshëm?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe i keni thënë ZPS-së, po citoj:

7 "Se unë do të thosha që kjo ka të bëjë me aspektet
8 politike të stafit lokal."

9 Kështu është?

10 PË. Po.

11 PY. Dëshmitar, tema e fundit që do të bisedoj me ju që ju
12 thatë se keni marrë kërcënime pas lufte. Kështu është?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe keni thënë se nuk e dinit se kush jua bënte këto
15 kërcënime. Por mendoni se ka të bëjë me faktin se jeni ish-
16 oficer i APJ-së, kështu?

17 PË. Po. Po.

18 PY. I keni thënë ZPS-së se nuk i keni cekur këto shqetësime
19 sa i takon sigurisë suaj me TMK-së asokohe. Kështu është?

20 PË. Po, kështu është.

21 PY. Dhe keni thënë se nuk i keni cekur këto shqetësime tuajat
22 për sigurinë tuaj me ish-kolegë të Shtabit të Përgjithshëm të
23 cilët kishin marrë pjesë në Qeverinë e Përkohshme. Kështu
24 është?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. I keni thënë ZPS-së dhe është në Pjesën 11, faqja 13, se
2 nuk i keni cekur këto shqetësimet tuaja pavarësisht nga fakti
3 se ata e dinin që ju nuk ishit kolaboracionist dhe se në fakt
4 ju kishit dhënë një kontribut të konsiderueshëm në UÇK gjatë
5 lufte. Kështu?

6 PË. Po, kështu është.

7 PY. Dhe kur ZPS-ja ju ka bërë pyetje në Pjesën 11, faqe 13,
8 lidhur me -- më mirë të lexoj pyetjen dhe përgjigjen tuaj.

9 Pyetja është kjo:

10 "Epo atëherë t'ju pyes se çfarë bënte Qeveria e
11 Përkohshme? E di se kanë -- janë bartur sa i takon posteve, po
12 këta ishin njerëz me të cilët ju kishit punuar nga afër dhe
13 kishin pushtet. Ku ishin këta njerëz?"

14 Dhe ju jeni përgjigjur:

15 "Unë nuk e di se çfarë lloj pushteti kishin."

16 Atëherë do t'ju bëj një pyetje. A mund të na shpjegoni
17 përse ju e vini në dyshim që anëtarët e Qeverisë së Përkohshme
18 e kishin pushtetin për t'i ndaluar këto kërcënime që iu
19 bëheshin juve?

20 PË. Po është e saktë se është e vërtetë që kjo si qeveri
21 ishte në formim, po pushtetin nuk ka mujt me e shtri ose me
22 pas një autoritet, [E pakuptueshme] edhe institucionet civile
23 nuk ishin të ndërtuara dhe nëpër nivelet komunale. Ose të
24 gjitha nivelet të cilat duhet të mund të punonin me Qeverinë e
25 Përkohshme.

1 E dyta, duhet të dihet që një pjesë e madhe edhe pse
2 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte në procesin e transformimit
3 të saj duke marrë me [E pakuptueshme] prej qershorit deri në
4 shtator ka pas periudhën e transformimit të saj që është punu
5 në atë drejtim, dhe normalisht që si qeveri nuk ka pas as
6 autori -- nuk ka pas mundësi të ketë një autoritet, të shtrijë
7 -- së parit është dashtë të ketë resurset e saj, të ketë edhe
8 vendet, të ketë edhe ndërtimin e vijës institucionale nga nalt
9 poshtë, domethënë qeveria deri në nivelet lokale komunale, pra
10 me mujt me pas atë autoritet dhe me pas edhe -- sikur të them,
11 autoritet edhe kontrollin në këto nivele.

12 Duke marrë parasysh që edhe në atë kohë ishte KFOR-i që e
13 kishte një autoritet më të lartë të sigurisë së Kosovë nuk
14 kishte mundësinë që t'i ketë të gjitha këto mundësitë të
15 kontrollit ose të ketë një autoritet të plotë të kontrollit në
16 territorin e Kosovës. Domethënë, shkurt në këto pikëpamje.

17 PY. A keni menduar ndonjëherë që UNMIK-u e kishte autoritetin
18 që t'ju ndihmonte apo e kishte mundësinë që t'ju ndihmonte, ta
19 them më mirë?

20 PË. Po në periudhën 1999 edhe UNMIK-u ishte procesin e
21 formimit të administratës së përkohshme, sa ka mundun të
22 ndihmon edhe ajo ishte -- nuk di. Nuk mund të jap mendimin për
23 të se është një organizatë ndërkombëtare e cila i ka sektorët
24 e veta dhe të drejtat e veta. Nuk e di sa ka mujt me hy në
25 ato, po për momentin, folim për 1999 si periudhë ka qenë e

1 tillë.

2 Dhe nuk mujt të -- sidomos për Qeverinë e Përkohshme nuk
3 ka mujt të ketë një kontroll të plotë.

4 PY. Faleminderit z. Zyrapi. Këtu mbyllem dhe pyetjet që unë i
5 kisha.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar i Trupit Gjykues ka
7 qenë çështje të cilën e trajtova përpara pushimit të fundit,
8 dhe duke pasur kohën do ju lutesha që ta diskutojmë në seancë
9 private pa praninë e dëshmitarit. Nuk e di nëse z. Emmerson
10 dëshiron të filloj këto dhjetë minuta para pushimit.

11 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
12 mund t'i kërkojmë dëshmitarit të kthehet në orën 11.30.

13 Z. Dëshmitar, për këtë seancë bashkë mbaruam. Do të bëjmë
14 pushim deri në orën 11.30. Mund të dilni tani nga salla.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, të
17 kalojmë në seancë private, z. Sekretar.

18 [Seancë private]

19 [Seancë private teksti i fshirë]

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
3 jemi në seancë publike.

4 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Bëjmë ndërprerjen e seancës këtu deri në 11.30, kur do të
6 rifillojë dhe pyetjet nga Mbrojtja e Veselit.

7 --- Pauza fillon në orën 10.55

8 --- Seancë rifillon në orën 11.31

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 sillni dëshmitarin në sallë.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
13 çaktivizuar]

14 Tani fjalët i ka z. Emmerson. Z. Emmerson përfaqëson z.
15 Kadri Veseli.

16 Vazhdoni, z. Emmerson.

17 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

18 Z. EMMERSON: [Përkthim]

19 PY. Mirëmëngjesi, z. Zyrapi. Edhe unë kam disa pyetje për ju
20 në emër të Kadri Veselit. Do doja të filloja me disa data të
21 lëvizjeve tuaja që t'i kem më të qarta. Dhe pastaj të shohim
22 më hollësisht periudhën e mbërritjes suaj në Kosovë, që më
23 duket se ka qenë 28 maji edhe largimit tuaj në kuadër të
24 negociatave të FARK-ut.

25 Na keni thënë disa herë që ju keni hyrë në Kosovë, pra,

1 keni mbërritur në Kosovë më 28 maj, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Nëse e kam kuptuar unë qartë ju qershorin, korrikun dhe
4 gushtin i keni kaluar duke udhëtuar në vende të ndryshme të
5 vendit ku vepronte UÇK-ja, kështu?

6 PË. E saktë.

7 PY. Këtë e keni bërë për të kuptuar shpërndarjen, aftësitë,
8 kapacitetet, a ishin të përgatitur sa duhet, a ishin të
9 trajnuar siç duhet në APJ dhe kështu me radhë dhe se si të
10 përgatiteshin sa më mirë këto forca në terren, kështu?

11 PË. E saktë.

12 PY. Gjatë këtij procesi ju i keni parë se sa vështirësi ka
13 pasur zona e Dukagjinit sa i takon mosmarrëveshjeve mes Tahir
14 Zemajt dhe Ramush Haradinajt, po unë kam një pyetje. Me sa ju
15 kujtohet ju kur jeni larguar ju nga Kosova me qëllim të
16 përgatitjes së marrëveshjes me qeverinë Bukoshi, pra, jeni
17 larguar për të përgatitur këtë marrëveshje me qeverinë
18 Bukoshi; kur?

19 PË. Në shator, në fillim të shtatorit.

20 PY. Jeni rikthyer, nëse e kam saktë, në fillim të nëntorit,
21 kështu?

22 PË. Të mesit të nëntorit.

23 PY. Mesi i nëntorit, në rregull. A pajtoheni me mua që
24 procesi i ristrukturimit apo rishpërndarjes së roleve të
25 Shtabit të Përgjithshëm përfundoi më 12 nëntor?

1 PË. Jo, aty ka filluar.

2 PY. Shumë mirë. Po mund të na thoni kur përfundoi si proces,
3 kur u kristalizua?

4 PË. Procesi nuk përfundoi asnjëherë. Ne kemi filluar më 12
5 nëntor dhe atëherë kemi mund ta rrisim këtë periudhën nëntor-
6 dhjetor-janar-shkurt me e arrit me e riorganizuar, kemi
7 shkuar. Mirëpo, si përfundim të procesit, jo.

8 PY. Mbase s'isha shumë i qartë. Procesi i ndarjes së detyrave
9 brenda Shtabit të Përgjithshëm, brenda, brenda vetë Shtabit të
10 Përgjithshëm, pra, rolet që iu jepeshin personave të ndryshëm,
11 ju po thoni që ky proces filloi më 12 apo përfundoi më 12?

12 PË. Ka filluar më 12. Me të 12 një pjesë është përcaktuar
13 kush do të është në rolet e Shtabit të Përgjithshëm, pastaj ka
14 vazhduar edhe më tutje.

15 PY. Po para këtij, para kësaj i vetmi person që njihej
16 publikisht në një fazë të mëhershme themi, duke filluar nga
17 qershori, 10, 11 qershor, pra, i vetmi person që njihej
18 publikisht ishte Jakup Krasniqi si zëdhënës, apo jo?

19 PË. Po, saktë.

20 PY. Domethënë ju keni folur për negociatat që çuan më pas në
21 marrëveshjen FARK-UÇK dhe thatë që një pjesë e negociatave
22 janë kryer në Stamboll, saktë?

23 PË. Saktë.

24 PY. A mund të na jepni edhe vendet e tjera, sa i takon
25 gjithmonë kësaj marrëveshje. Për shembull, një vend tjetër ka

1 qenë Tirana, apo jo? Po tjetër?

2 PË. Po, saktë, Tirana.

3 PY. Në një shtet tjetër përveç Shqipërisë, përveç Shqipërisë
4 dhe Turqisë kanë ndodhur negociatat në ndonjë shtet tjetër?

5 PË. Me mua jo, nuk e di. Për këto dy vende e di, po.

6 PY. Gjatë kohës që po bëheshin këto negociata ju keni qenë me
7 z. Veseli, saktë?

8 PË. Po, saktë.

9 PY. Përgjatë gjithë kohës flasim që po kryheshin këto
10 negociata?

11 PË. Po, saktë është.

12 PY. Pra, z. Veseli ka qenë jashtë Kosovës bashkë me ju gjatë
13 shtatorit dhe tetorit; gjatë të dy këtyre muajve?

14 PË. Po. Me mua ka qenë si për këto bisedime kur kemi filluar.

15 PY. Dua t'ju lexoj një paragraf të intervistës suaj për ZPS-
16 në.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është Pjesa 14, faqja 41,
18 rreshtat 8 deri 22 tek anglishtja; ndërsa te shqipja Pjesa 14,
19 faqja 37, rreshti 14 e në vijim.

20 PY. Unë po jua lexoj se është më lehtë kështu. Do jua
21 përkthejnë përkthyesit me gojë. Nëse ju preferoni ta vendosim
22 në ekran atëherë e vendosim.

23 "PY. Gjithashtu, po, përmendët ZKZ-në disa herë më
24 përpara. Ju jeni përgjigjur. ZKZ-ja ka qenë një nga drejtoritë
25 më të rëndësishme nga këndvështrimi ushtarak. Nga vera e '98-s

1 kush ka qenë përgjegjës për zbulim, kundërzbulim?"

2 Ju jeni përgjigjur:

3 "Nuk e di. Nuk kam informacione se çfarë strukture ka
4 pasur në atë kohë.

5 "PY. Po thjesht për ta ditur, z. Veseli a ka qenë
6 përgjegjës në atë kohë ose a mund të na thoni kur u bë
7 përgjegjës z. Veseli për zbulim, kundërzbulim?"

8 Ju jeni përgjigjur:

9 "Unë e di që nga nëntori e në vijim, ai ka qenë
10 përgjegjës për zbulim. Përpara kësaj unë nuk e di. Unë nuk e
11 kam njohur as strukturën as nuk e kisha parë ndonjëherë
12 strukturën deri në ato momente, kështu që unë nuk e di a ka
13 qenë ai më përpara apo jo".

14 Pra, ju e keni marrë vendimin që të caktohej z. Veseli
15 për zbulim dhe të dërgohej në Shqipëri për trajnim në muajin
16 nëntor. Pra, është vendim që e keni marrë ju si shef shtabi
17 apo jo?

18 PË. Po, për dërgimin në trajnim.

19 PY. Do flasim dhe për këtë vendim pak më vonë. Por duke qenë
20 se në shtator dhe në tetor ke qenë jashtë Kosovës me z. Veseli
21 edhe duke qenë se i thatë ZPS-së që nuk keni pasur dijeni për
22 përfshirjen e tij në zbulim gjatë verës, a mund të them që në
23 atë kohë, në nëntor e kam fjalën unë, nuk kishit asnjë arsye
24 për të besuar që ai të ketë qenë drejtuesi i një strukture
25 brenda UÇK-së që të ishte pjesë e Shtabit të Përgjithshëm?

1 PË. Për atë kohë e di që ka qenë në Shtabin e Përgjithshëm,
2 por çfarë pozicioni ka pas në atë kohë më herët nuk e di. Unë
3 foli veç për periudhën kur unë e kam njoft edhe kur ai ka
4 filluar, domethënë, këtë ristrukturimi dhe kur është vendos në
5 këtë detyrë.

6 PY. Po, tamam. Ju po flisni për periudhën nga nëntori e në
7 vijim, por para nëntorit ju keni qenë dy muaj me të dhe keni
8 negociuar marrëveshjen e FARK-ut jashtë vendit apo jo?

9 PË. Po.

10 PY. Edhe ju nuk keni pasur arsye të besoni se ai merrte
11 raporte të zbulimit nga brenda vendit apo të jepte udhëzime
12 oficerëve të zbulimit brenda Kosovës, sepse ju ishit bashkë po
13 merreshit me marrëveshjen e FARK-ut apo jo?

14 PË. Po, në atë kohë ne ishim jashtë edhe merreshim me
15 marrëveshjen. Kurse çka i përket strukturave të zbulimit ato
16 në atë kohë para asaj periudhe nuk kanë qenë edhe aq të
17 zhvilluara edhe në njësi më poshtë. Kështu që nuk ka qenë një
18 strukturë e tillë që ka mujtën të raportohet nga niveleve të
19 njësive më poshtë në për më lart në shtab. Mirëpo këto
20 raportime nuk kanë pas mundësi sipas edhe ofensivave që kanë
21 qenë të verës, po ashtu edhe si strukturë që nuk ka qenë e
22 organizuar dhe e riorganizuar në këtë drejtim.

23 PY. Gjatë kohës që ishit jashtë vendit, besoj se na e thatë
24 në fakt javën e kaluar, ju thatë që nuk bënit thirrje
25 telefonike me ata që ishin në Kosovë dhe as nuk merrnit

1 thirrje prej tyre, kështu?

2 PË. Po, kështu është.

3 PY. Po pse?

4 PË. Sepse komandanti i përgjithshëm ishte pranë neve aty. Ne

5 çfarë kishim e kishim me komandantin e përgjithshëm. [E

6 pakuptueshme] ndonjë informatë ose çdo send që kishte nevojë

7 për punën tonë që e ne bëjshim në atë kohë.

8 PY. Në një përgjigje të z. Misetit ju thatë se ristrukturimi,

9 pra, procesi filloi në nëntor dhe kjo ndodhi pjesërisht për

10 shkak të ndërlidhjes me shtete të tjera, përfshirë shtetet

11 anëtare të NATO-s, saktë?

12 PË. E bën edhe një herë pyetjen se nuk e kuptova mirë?

13 PY. Po, patjetër. Ju bëri një pyetje z. Misetit dhe ju iu

14 përgjigjët në transkript, në transkriptin e ditës dhe thatë,

15 ky riorganizim filloi në kontekst të diskutimeve me shtete të

16 tjera. Pra, nisi për shkak të diskutimeve që fillonim të bënim

17 me shtete të tjera, pjesërisht, pjesërisht për shkak të

18 informacioneve që kishte marrë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së,

19 saktë?

20 PË. Po, saktë.

21 PY. Pra, kishte ardhur kërkesa për një organizim më të mirë,

22 ristrukturim sepse duhej të kishte një strukturë të atillë

23 UÇK-ja që të kishin mundësi ta mbështetnin shtetet anëtare të

24 NATO-s. Të ekzistonte një strukturë e fortë ushtarake, saktë?

25 PË. Po, saktë.

1 PY. Një prej personave që ka udhëhequr këto diskutime për
2 fushën e zbulimit ka qenë z. Veseli, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Pra, ai shpesh ka komunikuar me zyrtarë të zbulimit që
5 punonin në ambasadat e shteteve anëtare të NATO-s, kështu?

6 PË. Kontakte s'di kanë pas të jashtme, por sa, më kë, krejt
7 nuk e di unë atë.

8 PY. Por nëse e kam unë saktë në atë kohë z. Veseli nuk kishte
9 ndonjë trajnim formal apo zyrtar për fushën e zbulimit apo jo?

10 PË. Po, saktë.

11 PY. Pra, pasi u vendos, unë po them, më datën 12 nëntor se ai
12 do të ishte përgjegjës për zbulimin ju vendosët që ai duhej të
13 trajnohej fillimisht te Shërbimi Informativ Shqiptar dhe të
14 mësonte se si duhej drejtuar një shërbim i tillë, kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Dhe përgjatë këtij procesi filloi të përdorej dhe termi
17 G2 për të përshkruar këtë funksion. Pra, G2-shi ishte një term
18 që si rregull e përdornin forcat e NATO-s, shtetet anëtare të
19 NATO-s apo jo? Po a ka qenë kjo për shkak të komunikimeve që
20 pati z. Veseli me forcat e NATO-s? Pra, ishte falë këtij
21 komunikimi që pati z. Veseli me forcat e NATO-s që lindi një
22 proces i tillë apo që u krijua një proces i tillë?

23 PË. Po, në përgjithësi edhe për atë, por në përgjithësi.

24 PY. Pra, kemi tre muaj në fillim ku udhëtoni nëpër territor
25 dhe vrojtoni çfarë po ndodh në terren në këto xhepa të

1 çorganizuar keni thënë ju në fund të majit, qershor, korrik.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani, a mund të shohim provën
3 materiale P606, faqja 3 nëse e kam referencën siç duhet. Kjo
4 është një provë materiale që jua kanë treguar më herët
5 pjesërisht nga ana e Prokurorisë. Është intervista për Zërin.
6 Keni dhe përkthimin në anglisht.

7 PY. Kjo është një intervistë që keni dhënë ju. Po kërkoj
8 edhe datën kur është botuar. Është fundi i nëntorit 1999. Në
9 fakt ja ku qenka në krye të faqes.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dua të fokusohemi te pyetja e
11 parë, te pyetja e parë ku thotë: "Këto njësi...". Në mes ta
12 zmadhojmë pak ju lutem.

13 PY. Ju kanë treguar një pjesë tjetër të kësaj interviste, por
14 unë dua të shohim çfarë keni thënë në terma më të përgjithshëm
15 për organizimin. Dhe do doja të na konfirmonit nëse ka qenë
16 vërtet kështu ajo që keni parë ju fillimisht në qershor,
17 korrik, gusht.

18 Pra, pyetja: "Këto njësi që vepronin në atë kohë në disa
19 rajone të Kosovës, a kishin lidhje të vijës komanduese mes
20 vete para shkuarjes suaj në luftë?"

21 Pra, ju kanë pyetur në thelb çfarë keni parë kur shkuat
22 në Kosovë. Dhe ju jeni përgjigjur kështu:

23 "Siç e ceka edhe më lart kishte përgjegjësi ushtarake,
24 por nuk kishte hierarki ushtarake të vijës komanduese
25 vertikale ku komanda më e ulët është detyruar deshi apo nuk

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Bislam Zyrapi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson

Faqe 57

1 deshi të respektojë urdhrat e komandës më të lartë. Pra, mund
2 të them se nuk kishte udhëheqje dhe komandim tërësor prej një
3 vendi apo një komande. Po kthehem prapë te detyra të cilat i
4 mora nga Shtabi i Përgjithshëm për kontrollimin e vijave të
5 frontit. Pas këtij kontrolli që iu bëra vijave të frontit u
6 ktheva në bazë dhe i raportova Hashim Thaçit, 'Lulit', Kadri
7 Veselit dhe Sokol Bashotës gjetjet e mia."

8 A është e vërtetë që ndër gjetjet e tuaja thuhej që në
9 disa zona, në disa brigada, në disa zona kishte persona të
10 emëruar nga baza lokale edhe për të kryer detyrat e zbulimit
11 edhe kundërzbulimit, por pa një koordinim apo pa pasur një
12 bazë nga më tej komandës apo komandës së brigadës apo të
13 zonës? Pra, kishte ndodhur brenda, vetëm brenda zonës, kështu?
14 PË. Po, është e saktë që kam deklaruar. Por kjo është
15 periudhë, e shpjegoj qershor, korrik. Në atë periudhë nuk ka
16 pas nëpër zona apo nëpër njësi të emëruar eprorë të cilët kanë
17 kryer veprimin e shërbimit kundërzbulimit. Ato tek janë
18 formuar tek kur kanë filluar brigadat të formohen, atëherë
19 kanë filluar të formohen këto [E pakuptueshme] dhe të vendosen
20 njerëz të cilët do të merren me këtë çështje. Kjo do të thotë
21 që shumë më vonë prej kësaj periudhe kur unë e shpjegoj.
22 Faktikisht në atë kohë nuk ka pasur njerëz të tillë dhe si
23 sistem të organizuar brenda sistemit të njësive ose
24 komandantëve, komandave. Ndoshta e ka kryer dikush detyrë të
25 tilla në ato, por nuk ka qenë si strukturë që është që unë nuk

1 e kam gjet në atë kohë.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë. Shohim provën materiale
3 P1386. Edhe kjo është një provë materiale që e keni parë edhe
4 më herët. Dhe unë do t'ju them që ky është një shembull i asaj
5 që sapo përshkruat ju nga fundi i korrikut. Edhe përkthimi në
6 anglisht.

7 PY. Nuk e di a ju kujtohet që e patë këtë dokument javën e
8 shkuar. Ju konfirmuat që kjo ishte një urdhëresë e nënshkruar
9 nga Ramush Haradinaj në fund të korrikut, 30 korrik. Edhe në
10 këtë urdhër, me sa duket, emërohet Faton Mehmetaj si oficer i
11 shërbimit të zbulimit për zonën ose nënzonën e Dukagjinit, se
12 kështu njihej asokohe, në atë periudhë kohore.

13 Po ky nuk është emërim i bërë prej Shtabit të
14 Përgjithshëm, apo jo? Ky është një emërim që e ka bërë Ramush
15 Haradinaj.

16 PË. Saktë.

17 PY. Më falni se ndërpreva më duket, okej, vazhdoni, më falni.
18 Pra, sa i takon emërimeve të personave në këto role të
19 ndryshme në nënzona të ndryshme apo xhepa aktivitetesh në këtë
20 periudhë kohore, flasim për fundin e korrikut, këta persona
21 nuk po emëroheshin nga Shtabi i Përgjithshëm dhe as nuk i
22 raportonit Shtabit të Përgjithshëm, kështu ka ndodhur?

23 PË. Ashtu është.

24 PY. Ndër emrat e ndryshëm të oficerëve të APJ-së që përmendët
25 sot paradite kur po i përgjigjeshit z. Misetic; ju dha një

1 listë të gjatë me emra të ish-oficerëve të APJ-së dhe thatë që
2 një nga këta oficerë ishte edhe Kurtesh Fondaj.

3 PË. E saktë.

4 PY. A e dini ju se Kurtesh Fondaj dha dëshmi publike pa asnjë
5 masë mbrojtëse në këtë sallë gjyqi para disa javësh, e dini
6 këtë?

7 PË. Kam dëgjuar.

8 PY. Ai po ashtu dëshmoi për emërimet, përgjegjësitë që kishin
9 oficerët e zbulimit mes zonave dhe brigadave gjatë kohës që
10 ishte ai përgjegjës si komandant brigade por edhe më pas.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëse është e mundshme do doja që
12 të shfaqej në ekran intervista. Është materiali i 25
13 qershorit, ju lutem, është me numër 17096, rreshti 7.

14 PY. Do t'jua lexoj se ende nuk është zbardhur shqipja e këtij
15 transkripti sepse është i kohëve të fundit. Kështu që do t'jua
16 lexoj unë në anglisht dhe do t'ju përkthehet prej përkthyesve
17 të sallës. Dua të dëgjoni atë që ka thënë ai dhe pastaj të
18 komentoni të na thoni a është e saktë ajo që ka thënë ai dhe
19 mund të keni ndonjë koment të mëtutjeshëm.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkova falje se ju dhashë
21 faqen e gabuar të transkriptit. Nuk është nevoja sidoqoftë.
22 Unë po e lexoj njësoj siç bëra herën e fundit.

23 "PY. A ke qenë kjo praktikë e zakonshme që një komandant
24 brigade të vendoste se kush do të ishte në komandën e tyre
25 lokale përgjegjës për zbulimin siç keni bërë dhe ju?"

1 Pra, Kurtesh Fondaj vetë dha dëshmi se ai kishte emëruar
2 specialistët e zbulimit në zonën e tij; oficerët e zbulimit.
3 Dhe pyetja edhe një herë:

4 "A ishte praktikë e përgjithshme kjo që komandantët e
5 brigadës të vendosnin se kë do të kishin në komandën e tyre
6 për zbulim, siç keni bërë dhe ju?

7 "PË. Jo vetëm për kundërzbulim, por për të gjitha
8 burimet. Komandanti i brigadës ishte autoriteti që përzgjidhte
9 ekipin e vet. Ai thjesht kërkonte ndonjëherë konfirmim prej
10 strukturave më të larta për ekipin e vet. Unë jua thashë edhe
11 dje rastin tim. Unë kisha kompetenca të plota të përzgjidhja
12 personat që doja pa marrë asnjë konfirmim, sepse ne nuk na
13 duheshin këto hapa administrativ në ato rrethana"

14 "PY. Pra, këta nuk ishin persona të zgjedhur prej Shtabit
15 të Përgjithshëm në brigada të ndryshme. Pra, nuk ishin
16 përzgjedhur prej Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

17 "PË. Të paktën jo gjatë kohës time si komandant brigade.
18 Ekipin tim e kam formuar vetë. Nuk e di si ka funksionuar në
19 brigada të tjera, por parimisht mendoj se ka funksionuar
20 njësoj."

21 Dhe ai e ka fjalën për periudhën dhjetor dhe janar,
22 dhjetor '98 - janar '99. Dhe thotë:

23 "Unë ndihmova si Brigadën 122 si Brigadën 124. Emërimi i
24 shtabit atje është bërë me pëlqimin e komandës së brigadës dhe
25 nuk ka pasur kurrfarë ndërhyrje në struktura më të larta apo

1 struktura komanduese në nivel më të lartë.”

2 “PY. Po meqë ishte kjo praktika në brigadën tuaj kush i
3 jepte urdhrat; ZKZ-ja juaj prej kujt i merrte urdhrat?

4 “PË. Nga komandanti i brigadës.

5 “PY. Faleminderit. Dhe kështu ka vazhduar deri të paktën
6 në janar, kështu?

7 “PË. Kështu e kam kuptuar -- kështu kam vepruar unë dhe
8 jam i bindur se kështu vazhdoi edhe më tej.

9 “PY. Faleminderit. Që të mos kemi paqartësi për
10 transkriptin, kjo ka qenë komenti për praktikën e përgjithshme
11 në zonën tuaj?

12 “PË. Po. Gjatë kohës që kam qenë unë komandant brigade
13 kjo ka qenë praktika, kështu vepronim. Për periudhat e tjera
14 nuk kam informacion të qartë se si është zhvilluar.”

15 Kjo ka qenë pjesë e intervistës së tij. Ndalojmë këtu për
16 një çast. Ju keni pasur një panoramë më të gjerë, sepse kishit
17 inspektuar forcat në periudhën qershor, korrik dhe gusht.

18 Përshkrimi që na dha Kurtesh Fondaj, a është një përshkrim
19 tipik sa i takon zyrtarëve të ZKZ-së, mënyra se si ata
20 emëroheshin?

21 PË. Po, saktë është ashtu siç e ka shpjeguar, jo veç të ZKZ-
22 së por në përgjithësi edhe të zyrtarëve të tjerë në komandat e
23 brigadave dhe zonave.

24 PY. Pra, ata emëroheshin ose nga komandanti i brigadës ose në
25 nivel të zonës siç e kemi parë në rastin e Ramush Haradinajt

1 nga komandanti i zonës dhe urdhrat i marrin nga komandanti i
2 zonës apo nga komandanti i brigadës dhe këtyre u raportonin,
3 apo jo?

4 PË. Duhet të shpjegoj pak këtë. Në brigadë oficerët e
5 zbulimit i kanë dhënë raport komandantit të brigadës dhe
6 urdhrat janë marrë prej komandantit të brigadës në zonë,
7 komandantët e zonës. Kështu është vepruar dhe veprohet në
8 aspektet ushtarake edhe me rregulla, por edhe në atë kohë.

9 PY. Ka pasur ndonjë dallim atëherë në atë periudhë të hershme
10 se ajo që ka thënë Kurtesh Fondaj ka të bëjë me dhjetorin,
11 janarin, pra, që janë fazat e hershme të riorganizimit. Me
12 fjalët tuaja, ju vetë a mund ta përshkruani për anëtarët e
13 Trupit Gjykses ato që ju keni parë kur keni udhëtuar nëpër
14 terren në qershor, korrik dhe gusht? Dua të them a morët ju
15 dijeni për oficerët e zbulimit apo specialistët e zbulimit për
16 faktin që këta emëroheshin dhe caktoheshin me rol zbulimi siç
17 ishte, për shembull, rasti i Faton Mehmetajt apo kjo ishte një
18 gjë e rrallë? Thjesht për t'ju shpjeguar, për t'u dhënë një
19 ide Gjykatësve se çfarë keni parë ju gjatë këtij inspektimi
20 tremujor në lidhje me ZKZ-në në nivel lokal?

21 PË. Po, jo vetëm me ZKZ-në, por edhe sektorë të tjerë.
22 Çdoherë në këtë periudhë kur folim para se të formohen edhe
23 brigadat, eprorët në këto shtabe nëpër këto komanda janë
24 emëruar vetë nga komandantët e këtyre shtabeve dhe lokale dhe
25 njësitë që kanë qenë më poshtë. Kështu që dhe në atë periudhë

1 nuk ka pas një emërim të tillë që të thuhet një oficer për
2 zbulim dhe kundërzbulim, folim para kësaj periudhe; unë kam
3 gjet, nuk kam has që më është prezantuar ndonjëri prej tyre
4 eprorëve.

5 Por pas kësaj periudhe dhe [E pakuptueshme] siç e pamë
6 edhe prej korrikut, kanë filluar formimet e brigadave, kanë
7 filluar dhe të formohen edhe këto sektorët kur janë vendosur
8 edhe këta oficerët e zbulimit. Kështu, këta janë zbuluar --
9 domethënë janë vendosur sipas asaj që në brigada janë vendosur
10 nga komandanti i brigadës, janë propozuar e vendosur.
11 Normalisht me pëlqimin e komandantit të zonës dhe në zona të
12 njëjtë janë vendosur nga komandanti i zonave.

13 Nuk ka pas të bëjë aspak me shtabin. Se ne nuk i kemi
14 njoh të gjithë ata në ato zona dhe ata eprorë e kanë njoh më
15 mirë çdo njeri, çdo zonë, çdo komandant i ka njoh ushtarët e
16 vet edhe eprorët dhe ai ka vendosur se si mbas aftësive që i
17 kanë pasur. Neve ç'kemi mundur që t'i ndihmojmë, t'i trajnojmë
18 aq sa kemi mundur t'i trajnojmë, t'i japim mundësi që ai të
19 aftësohet më mirë në atë drejtim, kaq.

20 PY. Në këtë aspekt, po flasim për procesin e stërvitjes që ka
21 filluar në fillim të '99-s, kështu?

22 PË. Procesi po, i trajnimeve.

23 PY. Për sa i takon procesit të trajnimeve është një proces ky
24 është ai lloj procesi i stërvitjes së përgjithshme ushtarake
25 që kemi dëgjuar paksa edhe në përpara.

1 PË. Po, saktë.

2 PY. Akademia ku një prej instruktorëve ishte Ekrem Rexha.

3 PË. Po, dhe shumë të tjerë.

4 PY. Edhe Sokol Bashota, përshirë edhe Sokol Bashotën.

5 PË. Po sigurisht edhe për Sokol Bashotën vetë mua dhe

6 eprorëve të tjerë.

7 PY. Dua t'ju pyes për një pasazh tjetër në intervistën tuaj

8 me ZPS-në.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është nga Pjesa numër 5, faqe 22,
10 rreshti 10, për ata që na ndjekin në anglisht; dhe faqe 24,
11 rreshti 12 për ata që na ndjekin në shqip.

12 PY. Është një varg i shkurtër pyetjes dhe përgjigjesh. --

13 Jeni pyetur kështu:

14 "Në rregull. Kemi dhe një pyetje tjetër. Keni cekur
15 policinë ushtarake të njësisë speciale. Po për zbulimin kishit
16 ndonjë sektor zbulimi?"

17 "PË. Po. Sektori i zbulimit sapo ishte krijuar. Njihej me
18 emërtimin G2 dhe shefi i këtij departamenti ishte Kadri
19 Veseli. Por kur ai u emërua në këtë post ai ndodhej jashtë
20 vendit rreth një muaj për t'u trajnuar."

21 Kështu është? Të kujtohet që e keni thënë kështu. Këtë
22 desha të them se mbase nuk e thashë.

23 PË. Po kur jam [E pakuptueshme] në momentin që ka shku në
24 trajtime.

25 PY. Po, do t'i kthehem kohës dhe provave për lëvizjet e tij,

1 por ajo që ju fort qartë ia keni thënë ZPS-së është se sektori
2 i zbulimit sapo ishte krijuar; njihej me emërtimin G2 dhe në
3 momentin kur Kadri Veseli është emëruar dhe ka qenë nëntor,
4 apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, ka vetëm një aspekt të dëshmisë suaj për të cilën do
7 ju kërkoja një sqarim nëse mundet. Kur jua kanë bërë pyetjen,
8 pra, përfaqësuesi i Prokurorisë javën që shkoi, kur jua bëri
9 pyetjen lidhur me drejtorinë që ekzistonin në momentin e
10 ristrukturimit dhe në bazë të shënimit përgatitor që jua kanë
11 paraqitur ju treguat se ata që, pra, ato që ekzistonin asokohe
12 ishin -- informacionet, operacionet, financat, zbulimi dhe
13 logjistika.

14 Pra, a mund të na thoni, pra, si ta kuptojmë këtë, duke
15 pasur parasysh faktin që ju keni thënë që sektori i zbulimit
16 është krijuar në momentin e emërimit të z. Veseli. Pra,
17 sektori i zbulimit në nivel të Shtabit të Përgjithshëm.

18 PË. Po. Këto kur kam thënë e kam shpjeguar se si edhe kur
19 them për drejtorinë më të hershme, drejtoria e informimit e
20 quajtur drejtoria e informacionit nuk ka qenë drejtori që
21 është quajtur drejtori e zbulimit dhe kundërzbulimit. E tash
22 çfarë detyre ka pas dhe si është nuk e di, nuk jam marrë me
23 atë çështje më herët.

24 Unë veç ceki që zbulimi dhe kundërzbulimi ky sektor ka
25 filluar të formohet në nëntor të vitit '98 me ristrukturimin e

1 Shtabit të Përgjithshëm. Në atë kohë dhe është vendosur z.
2 Kadri Veseli, kështu.
3 PY. Faleminderit. Deri në këtë moment e kemi kuptuar qartë
4 dëshminë tuaj, pra, që kemi tre muaj organizim kaotik në
5 terren pa ndonjë farë zbulimi të bashkërenduar që vepronte në
6 terren, saktë? Të paktën nuk mund të thuhet, pra, që
7 raportonte Shtabit të Përgjithshëm. Flasim për periudhën
8 qershor, korrik dhe gusht.
9 PË. Saktë, jo veç ky sektor por edhe sektorë e tjerë [E
10 pakuptueshme] kanë pas probleme.
11 PY. Pas këtyre erdhën dy muaj kur ju kishit dalë prej Kosove
12 bashkë me z. Veseli për të negociuar një bashkim midis anës së
13 Bukshit dhe anës së UÇK-së. Pra, për të qenë një forcë e
14 vetme luftuese pas së cilës keni rihyrë në Kosovë dhe ka
15 filluar procesi i riorganizimit. Në një moment ju e keni
16 dërguar z. Veseli jashtë vendit, thuajse menjëherë, fillimisht
17 për me u trajnu, por pastaj siç do e shohim edhe për detyra të
18 tjera, role të cilat morën rëndësi. Po që të trajnohen
19 stërvitej me shërbimin informativ shqiptar, fillimisht,
20 kështu?
21 PË. Po, ashtu është.
22 PY. Faleminderit. Tani nëse mundet dua që të shohim disa
23 materiale shkresore disa vula të vendosura në pasaportën e z.
24 Veseli që na janë dhënë nga Gjykata dhe nga autoritetet
25 zvicerane. Mund t'i [E pakuptueshme] si provë materiale.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të ketë
2 një kopje që është dhe më e qartë, kështu që do doja që të
3 zëvendësonim këto që ekzistojnë me faqe më të pastra, më të
4 qarta si pjesë e provave materiale. Prova materiale është
5 DKV1232 dhe do donim që të shtojmë si zëvendësues edhe
6 DKV0814.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
8 kundërshtim për këtë zëvendësim?

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Me kusht që të jetë ekzaktësisht
10 e njëjta faqe. Ne s'e shohim dot për një moment; duhet
11 verifikuar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po le ta
13 shënojmë një herë për identifikim dhe pastaj do të kemi
14 mundësi që ta shohim.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është në listën tonë të
16 prezantimit të provave dhe është nxjerrë prej ca kohe.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të na
18 jepni përgjigje pas pushimit të drekës?

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Të mos ta shënojmë tani, z. Emmerson. Më mirë ta riorroni
22 për t'u pranuar në provat materiale, pra, për të zëvendësuar
23 këtë pas pushimit të drekës.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Patjetër.

25 Ju lutem, të fillojmë me numrin e faqeve DKV1217 deri në

1 1234 *Revised*. Ajo që do të bëj është do t'i kthehem kësaj
2 prove sipas kësaj kronologjie. Por në fillim dua që të
3 shikojmë DKB1232.

4 PY. Po të shohim djathtas lart, vulën djathtas lart. Është
5 vulë daljeje nga aeroporti i Rinasit në Shqipëri. Thotë 10
6 shtator është koha kur ju kishit dalë prej Kosove me z.
7 Veseli. Nuk kemi një vulë hyrëse korresponduese, sepse nuk
8 janë të gjitha vulat këtu, por duket që është një fluturim me
9 të cilin largohet prej Shqipërisë. A ju kujtohet nëse kjo datë
10 përkon me ndonjë prej udhëtimeve që ju keni bërë së bashku?
11 Për shembull, fjala bie në Stamboll.

12 PË. Jo, 10 shtatori nuk është fluturimi për në Stamboll. 10
13 shtatori kjo mundet me qenë diçka krejt tjetër. Për Stamboll
14 tetori ka qenë kur kemi shkuar ne, data e takimit. Kjo është
15 diçka tjetër në sigurisht një udhëtim diku tjetër ku ka shku.

16 PY. Por në shtator këto negociatat për marrëveshjen e FARK-ut
17 a po zhvilloheshin?

18 PË. Bisedime pak kemi bërë se unë kam dal shpejt prej atyit
19 në shtator, nuk kam nejt shumë; kam dalë jashtë dhe çfarë kanë
20 bë atje nuk e di dhe si ka vazhduar më tutje. Unë kam qenë
21 jashtë në këtë periudhë, deri në tetor kur jam thirrur të
22 kthehem prapë dhe të vazhdoj. Pastaj kemi vazhduar bisedat dhe
23 marrëveshja që e ceka edhe më herët.

24 PY. Kuptova. Pra, kur jeni larguar z. Veseli ishte në Tiranë,
25 kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe siç e shohim këtu me sa duket e ka lëshu Tiranën për
3 me shku në një shtet tjetër në shtator, por ju vetë nuk e dini
4 me saktësi se për ku.

5 PË. Po, saktë nuk e di për ku ka shku [E pakuptueshme] në atë
6 kohë.

7 PY. Po të shohim, po të shohim, do ju lutesha të më ndihmoni
8 dhe me këtë -- më falni.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nxjerrim DKV1221.

10 PY. Është e datës 11 tetor. Është vulë largimi prej Cyrihut
11 me avion. 11 tetori ju kujton diçka, a mund të na ndihmoni ju
12 vetë ku, pra, mund të na ndihmoni, pra, se ku keni qenë ju
13 vetë në këtë moment?

14 PË. Në këtë moment kam qenë edhe unë jashtë, kam qenë në
15 perëndim.

16 PY. Takimi në Stamboll më duket se thatë se ishte në fillim
17 të tetorit, kështu?

18 PË. Jo, nuk e thashë në fillim të tetorit, por thashë në
19 tetor, më vonë prej kësaj date.

20 PY. Mirë.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po të shohim 1233, faqe 1233,
22 poshtë djathtas ka një vulë mbërritjeje në Rinas, më datë 11.
23 Tani a ishte fluturim i drejtpërdrejtë, a është menjëherë mbas
24 mesnatës, por duket që është fluturimi nga Zvicra, është
25 larguar nga Zvicra, nga Cyrihu dhe ka hyrë në Shqipëri më datë

1 11 tetor.

2 Ju ndihmon ndopak kjo?

3 PË. Fare, unë nuk kam qenë në atë kohë aty.

4 PY. Mirë. Ju lutem, e dimë që marrëveshja e FARK-ut është
5 arritur më datë 31 tetor, por zyrtarisht është lëshuar, pra,
6 ka dalë më 3 nëntor, kështu është?

7 PË. Po, zyrtarisht ka dalë, domethënë, nënshkruar është aty
8 shkruan data 2 nëntor me sa e di unë.

9 PY. Po, po edhe unë -- edhe mua sapo ma informuan që është 2
10 nëntori, po. Jo data 3. Faleminderit.

11 Tani vula tjetër në pasaportë me rëndësi është në faqen
12 me numër DKV1233, po kështu dhe është e datës 19, një çast ju
13 lutem.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo është 12, në faqen 1224. Ju
15 kërkoj ndjesë, nuk është kjo faqja. Po ajo që na duhet është
16 1233, po, DKV1233. Faqja majtas, pikë së pari, dhe vula në të
17 djathtë sipër të kësaj faqeje. 19 nëntor 1998, vulë nga
18 aeroporti i Rinasit në Shqipëri. Pra, është dalje.

19 PY. Thatë se e kishit emëruar z. Veseli në nëntor, pra, e
20 kishit emëruar për G2 në nëntor dhe pastaj e nisët për trajnim
21 pranë zbulimit shqiptar pak kohë pas kësaj. Kjo datë, kjo
22 dalje nga Rinasit është pasi ju e dërguat atë në Shqipëri për
23 t'u trajnuar pranë zbulimit shqiptar, kështu?

24 PË. Saktë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pastaj ju kërkoj të kalojmë tani

1 në faqen DKV1222. Ka një rinovim, pra, zgjatje të vizës si
2 refugjat në Bernë të datës 11 dhjetor.

3 PY. E shihni?

4 PË. Po.

5 PY. Faqja majtas. Është rinovim, pra, zgjatje e vizës --
6 rinovim i vizës, personalisht, pra, me praninë fizike aty më
7 11 dhjetor.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë tani në faqen
9 1233.

10 PY. Po bëjmë kapërcime në këtë dokument, z. Zyrapi, sepse
11 vulat e datave janë të vendosura jo gjithmonë sipas rendit
12 kronologjik. Por në faqen majtas këtu, vula e dytë djathtas,
13 pra, që është ajo shtylla djathtas e vulave. Shohim duke pasur
14 parasysh që kanë qenë dhe festimet e vitit të ri në Kosovë,
15 por kjo është një vulë e 31 dhjetorit hyrje në aeroportin e
16 Rinasit në Shqipëri, e shihni?

17 PË. Po.

18 PY. Pastaj më 5 janar.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Që është në faqen 1224, ju lutem.

20 PY. Faqja në të majtë, ajo që është vula e poshtme, pra, vula
21 e dytë e shtyllës së djathtë, në pjesën e poshtme të kësaj
22 faqe tregon mbërritje me avion më 5 janar në Bruksel dhe
23 largimi nga Brukseli më 10 janar që është vula menjëherë sipër
24 kësaj vule.

25 Tani prej këtu besoj,

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një moment ju lutem.

2 Të rikthehemi tani në faqen 1233. Në fakt 1223 [Sipas
3 përkthimit]

4 PY. Dhe në të djathtë sipër është një vulë e Sllovenisë që
5 tregon se më 13 janarit z. Veseli ka mbërrit me autoveturë në
6 Slloveni. E shihni?

7 PË. Po.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të na duhet t'i kthehemi këtij
9 dokumenti pas pak, por ju lutem ta nxjerrim në ekran numrin
10 11, më falni, 111491 deri në 111682-ET në faqet 1115558 deri
11 në 111559.

12 PY. Ndërkohë që presim që të shfaqet dokumenti në ekran, z.
13 Zyrapi, po ju jap kontekstin. Është një dokument që është
14 [REDAKTUAR].

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund ta hiqni nga ekрани. Po
17 thoni ta bëjmë në seancë private? Okej. Për të mbrojtur
18 ofruesin e informacionit.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
20 seancë private për këtë material për të mbrojtur ofruesin e
21 dokumentacionit.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Seancës -- jemi në

16 seancë publike.

17 Faleminderit, vazhdoni.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim]

19 PY. Do ta bëj dhe një herë pyetjen, për hir të seancës

20 publike.

21 A e dini ju se z. Veseli ka marrë pjesë fillimisht në

22 Rambuje, në konferencën e parë të Rambujesë mes 6 dhe 23

23 shkurtit?

24 PË. Po.

25 PY. A e dini ju se ai nuk ka udhëtuar nga Kosova dhe nuk ka

1 qenë pjesë e delegacionit që udhëtoi nga Kosova?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Kemi dëgjuar dëshmi nga Shaun Byrnes këtu; e keni
4 përmendur ju kreun e KDOM-it të SHBA-së. Ai tha që e shoqëroi
5 delegacionin që udhëtoi me avion nga Kosova drejt Rambujesë,
6 apo jo? Nuk e dinit këtë?

7 PË. Po është një udhëtim nga Kosova për në Rambuje, por është
8 ajo pasi janë kthyer delegacioni nga Rambujeja për të biseduar
9 me komandantët, domethënë, pas takimit të 26 shkurtit. Ajo
10 mund të jetë që është dërguar ky delegacion nga Kosova me
11 aeroplan shkon në Rambuje. Për këtë e di.

12 PY. Po. Në fakt Shaun Byrnes dha dëshmi këtu në këtë gjyq që
13 ka qenë udhëtim drejt Rambujesë fillimisht dhe se Kadri Veseli
14 nuk ka qenë një nga personat që ka shkuar në Rambuje nga
15 Kosova. Shoh që pohoni me kokë. Por duhet ta thoni me zë për
16 procesverbal.

17 PË. E saktë është, nuk ka qenë.

18 PY. Faleminderit. Atëherë dua të flasim për një aspekt tjetër
19 që ka dalë nga seanca juaj përgatitore dhe për të cilën do
20 kisha nevoja për sqarime.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Një çast sa ta gjej.

22 Atëherë shohim Shënimin Përgatitor numër 2 që nuk është
23 ende pjesë e provave gjyqësore edhe do doja që të shfaqej në
24 ekran materiali që mban numrin 121825 - 121869, faqja 26.

25 Mendoj se faqja që më nevojitet ka numër 121857.

1 Që të jemi të qartë është shtojca e këtij dokumenti. Dhe
2 numri i faqes, ah kjo është, kjo. Do shikojmë numrin 113,
3 pikën 113.

4 PY. Ju kanë treguar një listë shënimesh me shkrim dore nga
5 disa mbledhje që janë bërë në janar dhe në shkurt dhe keni
6 parë dhe gjatë dëshmisë tuaj këtu disa prej tyre. Dhe nuk
7 përmendet fare Kadri Veseli në asnjë prej këtyre shënimeve.

8 Por keni thënë në kuadër të bisedave që janë bërë, keni
9 thënë që keni marrë pjesë në disa prej këtyre të takimeve dhe
10 keni thënë:

11 "Gjatë kësaj kohe Kadri Veseli qëndroi në Kosovë një a dy
12 ditë përpara se t'i bashkohej delegacionit."

13 Ndalojmë këtu një herë. Bëhet fjalë për bisedimet e para
14 të Rambujesë, delegacioni i parë, për këtë e keni fjalën këtu?
15 PË. Po.

16 PY. Pastaj vijoni dhe thoni:

17 "Ai prezantoi Kasumin, Mentor Kasumin ë, para se të
18 largohej për në Rambuje."

19 Më pas keni thënë se nuk ju kujtohet nëse z. Veseli ka
20 marrë pjesë në ndonjë prej këtyre takimeve. Me fjalë të tjera
21 ju kujtohej që ka ndodhur disa takime gjatë kohës që ka qenë
22 ai në Kosovë për një apo dy ditë. Pra, ju nuk e kujtoni me
23 siguri në qoftë se ai ka marrë pjesë në këto takime gjatë
24 kohës që ka qenë në Kosovë në fund të janarit, në fillim të
25 shkurtit, kështu?

1 PË. Kështu është. Nuk ka pas takime në atë kohë, ato që
2 kështu jashtë takimit që jemi takuar kur më ka prur Mensur
3 Kasumi.

4 PY. Më falni, ju kërkoj ndjesë se nuk e dëgjova mirë. Po, po,
5 po do flasim dhe për Mensur Kasumin, por mbase pas pushimit të
6 drekës.

7 Po thjesht dua të më ndihmoni me një sqarim. Mbase është
8 një çështje përkthimi në shqip. Dua të më thoni a ngjasojnë dy
9 fjalë për shkak të mënyrës se si shqiptohen. Fjala e parë
10 është "zëvendës" dhe fjala e dytë është "zëvendësues".
11 Zëvendës dhe zëvendësues. Këto dy fjalë në shqip a ngjasojnë
12 shumë kur i dëgjon në shqip?

13 PË. Kur t'i dëgjosh po, por me veprime jo. Janë ndryshe,
14 ndryshe veprimet. "Zëvendës" është njeri, domethënë, "deputy"
15 i një komandanti apo drejtori, kurse "zëvendësues" zëvendëson
16 ajo është i cili e për momentin, përkohësisht mund të
17 zëvendësojë komandantin apo drejtorin, shefin e një sektori i
18 cili zëvendëson një prej zyrtarëve të atij sektori derisa nuk
19 kthehet drejtori apo shefi i sektorit apo komandanti.

20 PY. Faleminderit. Pra, një është zëvendësi, tjetri është
21 zëvendësues, por tingëllojnë njësoj në shqip, kështu?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
23 përgjigjeni me zë, Dëshmitar.

24 DËSHMITARI: Po, kjartë.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani shohim materialin DKV1423,

1 1350-ET [Sipas përkthimit] përbri materialit DKV1232 [Sipas
2 përkthimit] deri në 1251.

3 PY. Në të majtë keni shqipen. Në të djathtë kemi përkthimin
4 në anglisht një deklaratë të një dëshmitari. Është deklarata e
5 z. Kasumi në fakt. Ia ka dhënë Mbrojtjes, z. Kasumi, këtë
6 deklaratë.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem që të shqipja të shohim
8 faqen 1251, është faqja e fundit. Dhe shohim që është
9 nënshkruar nga Mensur Kasumi. Mos e njihni, e njihni
10 nënshkrimin e z. Kasumi?

11 PË. Jo, jo, nuk kam pas rast.

12 PY. Mirë. Po dua t'ju pyes për mënyrën se si është bërë pjesë
13 e Shtabit të Përgjithshëm z. Kasumi. Ai më herët ka qenë
14 zëvendësi i komandantit të zonës së Shalës, kështu?

15 PË. Po, saktë.

16 PY. Ju përmendët diçka për mënyrën se si ai u bë pjesë e
17 Shtabit të Përgjithshëm për shkak të shëndetit të tij. A ju
18 kujtohet si ndodhi konkretisht; fillimisht si erdhi Mensur
19 Kasumi tek Shtabi i Përgjithshëm?

20 PË. Po, më kujtohet mirë se për shkak të çështjet
21 shëndetësore ka qenë mirë me shëndet dhe nevojat të cilët
22 ishin. Atëherë është transferuar prej zonës së Shalës në Shtab
23 dhe duke marrë parasysh përvojat e tij të cilat ai i ka pasur
24 më herët, veç unë e njoh edhe në luftën e Bosnjës se ka qenë
25 zëvendëskomandant i njësisë vëzhguese, faktikisht Shtabit

1 Suprem të Armatës Boshnjake dhe ka pas një përvojë të tillë të
2 zbulimit dhe kundërzbulimit dhe ai është transferuar edhe më
3 shumë për çështje shëndetësore është transferuar në Shtabin e
4 Përgjithshëm në sektorin, faktikisht, në G2 ose në zbulim dhe
5 kundërzbulim.

6 PY. Që të jemi i qartë, ai para luftës ka qenë ndonjëherë
7 oficer policie?

8 PË. Po, sa kam dijeni ka qenë.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë. Shohim paragrafin 5, 1245
10 është faqja në anglisht dhe DKV1245 te shqipja. Paragrafi 5.

11 PY. Do doja që të shihnim tre a katër paragrafë të kësaj
12 deklarate për të parë nëse përputhet dhe me kujtesën tuaj:

13 "Në janar të 1999 kuptova se kishte një thirrje për
14 oficerët e trajnuar që të udhëtonin për në Divjakë të Kosovës
15 për t'u bërë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Unë isha një nga
16 oficerët më me përvojë në Kosovë dhe me kënaqësi do të shkoja
17 për të ndihmuar luftën nëse aftësitë e mia mund të përdoren më
18 mirë si pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Mund ta kisha
19 refuzuar. Askush nuk do të më kishte ndëshkuar apo qortuar mua
20 për këtë. Unë thjesht mund të vazhdoja të vijoja të luftoja në
21 zonën e Shalës, por ne ishim kolegë edhe ky propozim për mua
22 kishte kuptim, kështu që shkova në Divjakë.

23 Në Divjakë u bëra përgjegjës për Drejtorinë për
24 Përgatitjet e UÇK-së".

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë te paragrafi

1 tjetër. Paragrafi 6.

2 "Pra, në Divjakë u vendosa në krye të Drejtorisë së
3 Operacioneve të UÇK-së. Këtë pozitë e mora në shkurt, por
4 duhet të kuptoni se pjesën më të madhe të këtij muaji e kaluam
5 duke u përgatitur për rezultatin e negociatave të Rambujesë.
6 Në lidhje me pyetjen për z. Veseli, më kujtohet se ai nuk
7 ishte i pranishëm në Kosovë deri dikun mbas Rambujesë."

8 Paragrafi 7:

9 "Pas kolapsit të konferencës së Rambujesë e dinim, kishte
10 gjasa të mëdha që NATO të ndërhynte dhe pjesa më e madhe e
11 punës sime si Shefi i Operativës ishte të përpiqesha të
12 vendosja një sistem të identifikimit të caqeve për aeroplanët
13 e NATO-s. Duhet të krijoja dhe një sistem të besueshëm
14 komunikimi me Komandantët e Zonave në terren në mënyrë që ata
15 të raportnin lëvizjet e trupave serbe. Më pas do ta
16 transmetoja këtë informacion burimeve të NATO-s në mënyrë që
17 ata t'i dinë caqet legjitime për t'u goditur.

18 Kjo mund të duket si gjë e lehtë, por në fakt ishte tepër
19 e vështirë. Ne thjesht nuk kishim sisteme të komunikimit,
20 madje as për detyrë kritike. Në të gjithë Zonën e Shalës ishte
21 vetëm një telefon satelitor. Përpjekja për të siguruar nga të
22 gjitha pjesët e Kosovës ishte e pamundur. Por ne bënë më të
23 mirën që mundëm."

24 Vijon në paragrafin 9:

25 "Pas Rambujesë dhe formimit të Qeverisë së Përkohshme

1 roli im vazhdoi si Shefi i Drejtorisë së Operativës, por në
2 javën e parë të prillit 1999 u bëra edhe Shefi i Inteligjencës
3 Ushtarake (ZKZ-së)."

4 Thotë që i ka treguar dhe një urdhër; thotë 4 maj dhe se
5 e ka nënshkruar në atë cilësi.

6 Ai po ashtu thotë:

7 "Për, por për të thënë me sinqeritet të plotë nuk më
8 kujtohet ky urdhër specifik, por mund të konfirmoj se
9 nënshkrimi ishte në [E pakuptueshme]."

10 Pastaj vazhdon:

11 "Më duhet të them se në realitet ky pozicioni ishte
12 kryesisht fiktiv, nuk kishte asnjë strukturë të inteligjencës
13 brenda Kosovës në atë kohë dhe ideja se mund të krijojmë
14 kundërzbulimin është për t'u qeshur në të gjitha rrethanat.
15 Përpiquni të kuptoni se unë mezi komunikoj me komandantët e
16 zonave për të përcaktuar vendndodhjen e forcave serbe. Ishin
17 duke djegur fshatrat tonë dhe ishin duke zhvendosur civilët me
18 qëllim të thirrjes së sulmeve ajrore të NATO-s. Nga
19 prioritetet tona në Shtab të Përgjithshëm ai përcjell ose [E
20 pakuptueshme] të NATO-s lidhur me caqet ushtarake ishte më i
21 rëndësishmi."

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A do të ketë ndonjë pyetje,
23 kundërshtoj.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo një, por disa.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Atëherë unë do të thoja kjo ishte

1 shumë e gjerë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbarojeni ju
3 lutem këtë lexim, por duhet të bëni patjetër një pyetje.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Patjetër. Më duket se drejt
5 fundit ishte. Ja ta gjej ku e lashë.

6 PY. Pra, ta mbaroj.

7 "Inteligjenca përtej nivelit më bazik, ku është lokacioni
8 fizik i njësive armiqësore, policët, paramilitarët që
9 përpiqeshin të digjnin shtëpitë tona, të vrisnin familjet tona
10 nuk ekzistonin në nivel të Shtabit të Përgjithshëm. Thjesht
11 nuk ekzistonin.

12 Pra, për t'u përgjigjur edhe një herë, a kam qenë unë
13 Shefi i ZKZ-së që prej 2 prillit..."

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Kundërshtoj. Mendoj që ju morët
15 një vendim në lidhje me këtë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po më duket sikur thatë që do më
17 lejonit ta përfundoja paragrafin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë
19 çfarë doni të thoni. Tani bëni një pyetje.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë. Mirë atëherë po veproj
21 kështu.

22 PY. Pikë së pari, Mensur Kasumi kujton se është kyçur në
23 Shtabin e Përgjithshëm në cilësinë e drejtorisë operative dhe
24 ka qëndruar në atë rol, por ka marrë dhe një funksion shtesë
25 të ZKZ-së pas formimit të Qeverisë së Përkohshme.

1 A mund të ketë pas, a mund -- a ka të drejtë ai apo jo
2 mendoni se ai menjëherë sa ka ardhur ka marrë përsipër rolin e
3 zbulimit.

4 PË. Po, me transformimin e tij në Shtabin e Përgjithshëm -
5 është e vërtetë që është transferuar një herë në drejtorinë
6 operative, është e qartë, për shkak përvoje që e ka. Mirëpo
7 përvoja e tij, njohuritë e tij që ka pasur dhe në atë kohë në
8 janar shumë qartë është që është qit të zëvendëson z. Veseli
9 deri për shkak të mbledhjeve të këtyre informacioneve dhe më
10 pas një oficer të zbulimit i cili do të ketë Shtabi i
11 Përgjithshëm derisa nuk kthehet z. Veseli edhe kjo është ka
12 qenë, por domethënë këtë rol e ka luajtur. Pastaj që shpjegon
13 këtë më tutje këtë pjesën pas bombardimit, kjo është e qartë
14 se është kthyer prapë në te sektori i operativës dhe kanë
15 vazhduar të informojnë informata të cilat ia kanë kërkuar edhe
16 nga NATO edhe shtabi. Kështu që unë kështu e mirë më kujtohet
17 që ka qenë në këtë veprim.

18 PY. Po. Shumë e dobishme. A ka mundësi që ai siç thashë më
19 herët të ketë qenë një zëvendësues për z. Veseli tek SHIK-u
20 kur u formua Qeveria e Përkohshme në prill dhe jo zëvendësi i
21 tij. Pra, para formimit të Qeverisë së Përkohshme ai punonte
22 në drejtorinë operative apo jo?

23 PË. Nëse nuk ka qenë në SHIK, dua të jem i qartë se SHIK-u
24 është formuar pas formimit të qeverisë edhe të përkohshme. Po
25 folim për periudhën e janarit dhe shkurtit, sidomos pas

1 janarit kur ishte zbulimi dhe kundërzbulimi. Ende nuk ishte
2 Qeveria e Përkohshme. Ne folim për këtë sektor në zbulim dhe
3 kundërzbulim.

4 Ai ka qenë në drejtori operative, por është marrë me këtë
5 drejtori se s'ka pas njerëz në këtë drejtori fare për të
6 punuar dhe për të dhënë disa informacione ose për të vepruar
7 si oficer derisa nuk kthehet z. Veseli.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është koha e
9 pushimit të drekës. Nëse mundeni ta ndërprisni këtu.

10 Dëshmitar, tani do bëjmë një orë e gjysmë pushim. Do
11 rifillojmë në orën 14.30. Mos harroni që nuk duhet të flisni
12 me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit. Tani mund
13 të dilni nga salla bashkë me Asistenten e sallës.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
16 orën 14.30.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

18 --- Seanca rifillon në orën 16.29

19 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
20 për praninë. Ndjesë për vonesën, por nuk kishim ç'të bënim.

21 Ju lutem, z. Sekretar, të kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 jemi sërish në seancë publike.

13 KRYETARI I TRUPI GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
14 ndërprerjen e seancës deri nesër në mëngjes në orën 9.00.

15 --- Seanca mbyllet në orën 16.33

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25